



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 119 Akti

Nr. 137 Vendimi  
Tiranë, më 09.04.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Lulzim Hamitaj</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Firdes Shuli</b>	<b>Relatore</b>

me sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo, në datën 05.04.2019, dhe datë 09.04.2019, në Pallatin e Koncerteve (Ish-pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Edison Ademi, prokuror/drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.**

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Nenet 179/b, A, Ç, D, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”;**

**Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015,** “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012** “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoji relatimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, dhe mori në shqyrtim shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin, z. Edison Ademi, bazuar në kriterin e kontrollit të pasurisë dhe të aftësive profesionale, mbështetur në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016 dhe, në përfundim, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Z. Edison Ademi, është subjekti i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, dhe në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “Ligji nr. 84/2016”), i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Edison Ademi, ushtron funksionin e prokurorit/drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë që prej muajit shkurt të vitit 2016. Ai u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar në shortin e datës 15.03.2018.

3. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.01.2018, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me nr. \*\*\* prot., datë 29.01.2018, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”) ka vënë në dispozicion aktin përfundimtar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë të subjektit të rivlerësimit, z. Edison Ademi (18 fletë).

4. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 04.07.2018, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me nr. \*\*\* prot., datë 24.07.2018, Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, ka vënë në dispozicion raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Edison Ademi (28 fletë).

5. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ka zhvilluar shortin në datën 15.03.2018, dhe sipas procesverbalit të datës 15.03.2018, subjekti i rivlerësimit, z. Edison Ademi, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit, nga trupi gjykues nr. 1, i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, anëtare, Firdes Shuli, relatores dhe Lulzim Hamitaj, anëtar.

6. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: ILDKPKI, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Prokuroria e Përgjithshme.

7. Me vendimin nr. 1, datë 20.03.2018, trupi gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit, z. Edison Ademi, bazuar në të tre komponentët, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren, znj. Alma Faskaj. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

8. Në datën 06.06.2018, subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t'u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Në datën 07.06.2018, nëpërmjet komunikimit elektronik, subjekti deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

9. Me vendimin nr. 35 të Komisionit, datë 19.06.2018, është vendosur rishpërndarja me short e çështjeve të komisioneres Alma Faskaj, për shkak të mungesës së saj për një afat të pacaktuar, për arsye shëndetësore.

10. Pas procedurës së shortit, për çështjet e komisioneres Alma Faskaj, në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, shortuar në datën 15.03.2018, me vendimin nr. 40, datë 16.07.2018, Komisioni ka vendosur që për subjektin e rivlerësimit, z. Edison Ademi, në vend të komisioneres Alma Faskaj, të caktohet komisionerja Genta Tafa (Bungo).

11. Me deklaratën e datës 16.07.2018, komisionerja Genta Tafa (Bungo), ka deklaruar se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit, z. Edison Ademi.

12. Në datën 13.02.2019 subjektit iu komunikua në rrugë elektronike ndryshimi i trupit gjykues për shkak të zëvendësimit të komisioneres Alma Faskaj, me komisioneren Genta Tafa, duke iu bërë me dije e drejta për t'u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit.

13. Në datën 16.02.2016, nëpërmjet komunikimit elektronik (por edhe në rrugë zyrtare me shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 20.02.2019 të protokolluar pranë Komisionit), subjekti është shprehur se nuk ka në dijeninë e tij asnjë situatë, fakt apo rast që të krijojë konflikt interesi me anëtarin e re të trupit gjykues.

14. Me vendimin nr. 2, datë 13.03.2019, trupi gjykues vendosi:

- i) të përfundojë hetimin paraprak në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, dhe atë të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Edison Ademi;
- ii) të miratojë rezultatet paraprake të hetimit;
- iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se provat e grumbulluara kanë nivelin e provueshmërisë sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, duke i kaluar barrën e provës mbi rezultatet paraprake të hetimit kryesisht, për të paraqitur prova e shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, sipas parashikimeve të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016;
- iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për të drejtat e tij në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, dhe të drejta të tjera sipas neneve 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative;
- v) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtën për t'u njohur me dosjen, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarëve, si dhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta (26.03.2019).

15. Në datën 15.03.2019, subjektit iu komunikuan në rrugë elektronike rezultatet e hetimit.

16. Në datën 19.03.2019, subjekti u paraqit personalisht pranë ambienteve të Komisionit, ku u njoh me dokumentacionin fizik dhe mori në dorëzim në formë elektronike (CD) dosjen e hetimit administrativ, vërtetuar me deklaratën e nënshkruar prej tij të datës 10.03.2019.

17. Në datën 21.03.2019, në rrugë elektronike dhe nëpërmjet postës zyrtare, protokolluar nga Komisioni me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.03.2019, subjekti paraqiti kërkesë drejtuar Komisionit, për vënie në dispozicion të disa akteve dhe dokumenteve.

18. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga subjekti dhe konstatoi se kjo kërkesë nuk është në funksion të marrjes së provave të reja, sipas parashikimeve të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 3, datë 25.03.2019: (i) refuzoi marrjen e saj në konsideratë; si dhe (ii) vendosi shtyrjen e afatit për paraqitjen e parashtrimeve të subjektit në lidhje me rezultatet e hetimit, për në datën 29.03.2019, deri në orën 16:00. Lidhur me sa më sipër, subjektit i është komunikuar në rrugë elektronike, në datën 25.03.2019.

19. Në datën 29.03.2019, në rrugë elektronike dhe me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 01.04.2019, të protokolluar nga Komisioni, subjekti ka vënë në dispozicion shpjegimet e tij mbi rezultatet paraprake të hetimit si dhe dokumentacionin përkatës. Bashkëngjitur me parashtrimet, subjekti ka paraqitur disa kërkesa, të cilat, pasi u verifikuan rezultuan të njëjta me ato të paraqitura më parë elektronikisht, në datën 21.03.2019 (dhe me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.03.2019).

20. Me vendimin nr. 4, datë 01.04.2019, pasi u refuzuan kërkesat e subjektit, të cilat rezultuan të përsëritura dhe jo në funksion të marrjes së provave të reja, sipas parashikimeve të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Edison Ademi, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016.

## II. SEANCA DËGJIMORE

21. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Edison Ademi, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në datën 05.04.2019, në Pallatin e Koncerteve (Ish-pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo.

22. Pasi nga ana e kryesuesit të seancës u kryen njoftimet për publikun, për mediat e pranishme dhe për subjektin e rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit, z. Edison Ademi, parashtrroi disa kërkesa të paraqitura edhe në formë shkresore në dokumentin "*Parashtrime të përgjithshme në seancë dëgjimore*", të cilat u administruan nga sekretarja gjyqësore gjatë seancës dëgjimore.

23. Trupi gjykues u tërhoq në dhomë këshillimi, për të verifikuar kërkesat e subjektit të rivlerësimit dhe, me vendimin nr. 5, datë 05.04.2019, vendosi:

i) të refuzojë kërkesat nr. 10 dhe nr. 11 për thirrjen e ekspertit kontabël dhe thirrjen e përfaqësuesit të ILDKPK-së, me cilësinë e dëshmitarëve, bazuar në germat "a", "b", "c", pikën 6, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016;

ii) të refuzojë të gjitha kërkesat e tjera të listuara, përkatësisht në pikat nr. 1-9 dhe nr. 12, për shkak se nuk plotësojnë kriteret e nenit 49, të ligjit nr. 84/2016.

24. Subjekti, pasi u ripyet në lidhje me kërkesa të tjera të mundshme, deklaroi se nuk ka kërkesa të tjera përveç atyre të deklaruara në seancë, trupi gjykues shpalli vendimin nr. 5, datë 05.04.2019.

25. Më pas, fjalën e mori relatorja e çështjes, e cila paraqiti rezultatet paraprake të hetimit mbi kriterin e pasurisë dhe kriterin profesional.

26. Në vijim, z. Edison Ademi, shprehu qëndrimin e tij, duke parashtruar shpjegime dhe opinione lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, si dhe depozitoi dokumentacionin mbi të ardhurat e vëllait të subjektit në emigracion, z. A. Ademi, legalizuar me vulën origjinale *Apostille*, të cilat iu rikthyen në seancën e shpalljes së vendimit.

27. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, shprehu qëndrimin e tij përfundimtar, duke kërkuar konfirmimin në detyrë.

28. Në datën 09.04.2019, u zhvillua seanca për shpalljen e vendimit.

### **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Subjekti i rivlerësimit, z. Edison Ademi, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij. Ai ka zbatuar me përpikmëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë provat dhe shpjegimet përkatëse. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, por shfaq mungesë të etikës profesionale në përfundim të kësaj seance, menjëherë pas dhënies së vendimit të Komisionit.

### **IV. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI**

#### **IV.1 VLERËSIMI I PASURISË**

##### **IV.1.1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja:**

Nga aktet e ILDKPKI-së rezulton se subjekti ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private nga viti 2004 (për vitin 2003) deri në vitin 2017 (për vitin 2016). Në datën 27.01.2017, sipas ligjit nr. 84/2016, subjekti ka dorëzuar “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”, pranë ILDKPKI-së, në përputhje me nenin 32/1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ky institucion ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe personat e lidhur sipas neneve 30 – 33, të ligjit nr. 84/2016 dhe me aktin nr. \*\*\* prot., datë 18.01.2018, ka konkluduar se për këtë subjekt:

- a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) ka kryer deklarim të rremë;
- e) subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

##### **IV.1.2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni:**

Pasi është njohur me konstatimet në raportin nr. \*\*\* prot., datë 18.01.2018, të ILDKPKI-së, organit kompetent ligjor, që sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, është ngarkuar për të bërë vlerësimin e pasurisë të subjekteve të rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, por edhe në seance dëgjimore subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pretendimet e tij për shkelje të ligjit nr. 84/2016 dhe ligjeve të tjera nga ana e këtij institucioni, duke pretenduar gjithashtu se, procedurat e vlerësimit të pasurisë nga ky institucion janë bërë me mangësi dhe problematika të dukshme, dhe se nuk janë marrë parasysh dokumente të ligjshme të dorëzuara prej tij rregullisht ndër vite.

Për sa i takon këtyre pretendimeve, trupi gjykues, vlerësoi se nuk është në tagrin e tij marrja në shqyrtim e tyre, pasi Komisioni ka për kompetencë vetëm rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, sipas ligjit nr. 84/2016. Referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, nr. 2/2017<sup>[1]</sup> dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi për subjektet e rivlerësimit, që nuk bazohet dhe as është i detyruar të kushtëzohet nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Për këto shkaqe, si dhe duke pasur në konsideratë faktin që ILDKPKI-ja ka vënë në dispozicion të Komisionit deklaratat periodike të subjektit ndër vite, deklaratën për “Vetting” dhe çdo dokument të administruar prej këtij institucioni, me vendimin nr. 5, datë 05.04.2019, Komisioni, vendosi refuzimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për pyetjen në cilësinë e dëshmitarit, të përfaqësuesit të ILDKPKI-së.

Lidhur me pasuritë e subjektit të rivlerësimit, z. Edison Ademi, është kryer një proces i plotë hetimi administrativ, bazuar në deklaratimet e subjektit pranë ILDKPKI-së, provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar pranë Komisionit, çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, si dhe komunikimet me subjektin, sipas nenit 46 të këtij ligji dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

Hetimi paraprak administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë, konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklaratimeve të rreme; (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin nëse subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 61/3, të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

---

[1] “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se, “procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

Hetimi administrativ nga ana e Komisionit, sipas neneve 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84 /2016, është kryer në lidhje me pasuritë si vijojnë:

1. Apartament banimi me sip. 130 m<sup>2</sup> (dy hyrje nga 65 m<sup>2</sup>, adaptuar në banesë të përbashkët me prindërit), me adresë: Rr. “\*\*\*”, P. \*\*\* “Vlorë”, H. \*\*\*, K. \*\*\*, Njësia Administrative Vlorë, \*\*\*, prenotuar në vitin 2003, banuar prej vitit 2004, e regjistruar në pronësi në datën 07.08.2012, me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 03.08.2012. Vlera e blerjes: 45.000 USD. Pjesa takuese: 100 %.

Burimi i deklaruar i krijimit:

- i) Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., datë 14.10.2000, për shitjen e banesës së prindërve nr. \*\*\*, në lagjen “\*\*\*”, Vlorë; në vlerën 2.500.000 lekë, me gjithë orenditë në të;
- ii) Kontratë nr. \*\*\* kredie, nr. \*\*\*, datë 07.11.2003, pranë “Alpha Bank”, për shumën prej 30.000 USD (afati 12 vjet).

**1.1** Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se:

i) ZVRPP-ja Vlorë<sup>1</sup> konfirmon se, në emër të shtetasit Edison Xh. Ademi, rezultojnë dy pasuri të llojit apartament, përkatësisht pasuria nr. \*\*\*, me sip. 65 m<sup>2</sup> dhe pasuria nr. \*\*\*, me sip. 65 m<sup>2</sup>.

ii) OSHEE-ja<sup>2</sup> konfirmon në emër të Xh. A kontratën e furnizimit me nr. \*\*\*, në instancën Vlorë, lagjja “\*\*\*”, kontratë aktive, me datë hapje 31.10.2004. Kjo kontratë përputhet me numrin e kontratës në librezën e energjisë të vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit<sup>3</sup>.

**1.2.** Lidhur me mënyrën e fitimit të pronësisë:

Nga aktet e administruara, u konstatua se:

- Me kontratë prenotimi për shitje nr. \*\*\*, datë 04.09.2003<sup>4</sup>, midis sipërmarrësit B. R dhe porositorit Edison Ademi, ka një marrëveshje për blerje apartamenti 3+1, me sip. ndërtimi 130 m<sup>2</sup>, në katin e \*\*\* të godinës, në çmimin e shitjes 45.000 USD.

- Me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 03.08.2012<sup>5</sup>, z. Edison Ademi, ka blerë nga shoqëria ndërtimore “\*\*\*” sh.p.k., dy apartamente me nga 65 m<sup>2</sup>, në vlerën prej 45.000 USD, nga 22.500 USD, secili, likuiduar jashtë zyrës noteriale, sipas kushteve të vendosura në kontratën e prenotimit për shitje me nr. \*\*\*, datë 04.09.2003.

Nisur nga fakti që, me cilësinë e të porositorit në kontratën e porosisë, është z. B. R, ndërsa në cilësinë e shitësit në kontratën e shitblerjes është shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., pra, dy subjekte të ndryshme, u bë verifikimi në faqen *online* të QKB-së. Nga ekstrakti historik i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit “\*\*\*” sh.p.k., rezulton se ky subjekt është i regjistruar si subjekt tregtar në datën 04.09.1996, me aktivitet në qytetin e Vlorës, në fushën e punimeve të ndërtimit të të gjitha llojeve, me përfaqësues ligjor e ortak të vetëm z. B. R, i cili që prej datës 30.06.2009 ka

<sup>1</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\*, datë 27.06.2018, nga ZVRPP-ja Vlorë, në dosjen e Komisionit.

<sup>2</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\*, datë 22.10.2018, nga OSHEE-ja, në dosjen e Komisionit.

<sup>3</sup> Shihni dokumentacionin e dërguar nga subjekti në datën 11.10.2018, në dosjen e Komisionit.

<sup>4</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2 dërguar nga z. Edison Ademi në datën 24.10.2018.

<sup>5</sup> Shihni aneksin nr. 4/1 në dosjen e ILDKPKI-së .

qenë edhe administrator i kësaj shoqërie. Me këtë cilësi, ai ka nënshkruar kontratën e porosisë, në datën 04.09.2000. Pra, kontrata e prenotimit është lidhur me administratorin e shoqërisë, shtetasin B. R, ndërsa kontrata e shitjes është lidhur me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., me administrator po këtë shtetas.

### **1.3. Lidhur me përfitimin e mundshëm të subjektit për blerjen e kësaj pasurie:**

**1.3.a.** Referuar udhëzimit nr.1, datë 08.05.2003, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave të vlerave në tregun e lirë të banesave dhe koeficientit "K"<sup>6</sup>, një apartament me sip. 130 m<sup>2</sup> në vitin 2003 në qytetin e Vlorës kushtonte 6.349.850 lekë, ndërkohë që, subjekti e ka blerë me çmimin 45.000 USD ose 5.655.050 lekë<sup>7</sup>, pra në një vlerë rreth 700.000 lekë nën çmimin e tregut.

Lidhur me këtë konstatim, pas kalimit të barrës së provës, subjekti shpjegoi se<sup>8</sup> udhëzimi i mësipërm është interpretuar gabim, pasi janë përdorur vlerat maksimale të tij, duke sjellë në vëmendje se banesa e tij nuk ndodhet buzë detit. Gjithashtu, për të mbështetur pretendimet e tij, subjekti vuri në dispozicion: (i) deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 20.03.2019, të shtetasit B. R, si administrator i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., sipas të cilës, çmimi i prenotimeve të apartamenteve ka qenë 340 USD/m<sup>2</sup> dhe 40.000 – 47.000 lekë/m<sup>2</sup>; (ii) disa kontrata shitblerjeje të lidhura në vitin 2012 me palë shitëse “\*\*\*\*” sh.p.k., nga të cilat rezulton se çmimi i shitjes për m<sup>2</sup>, është i krahasueshëm me atë të kontratës së subjektit të rivlerësimit, të cilat Komisioni i mori në konsideratë.

**1.3.b.** Nga vërtetimet e marra në rrugë zyrtare nga prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Pogradec dhe Sarandë, ku subjekti ka ushtruar detyrën<sup>9</sup>, nuk evidentohen raste që shtetasi B. M. R dhe subjekti juridik, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., të jenë përfshirë në materiale kallëzuese, çështje penale apo procedura të tjera ligjore. Nga Prokuroria e Vlorës<sup>10</sup> vërtetohet se nuk figuron të ketë vendimmarrje (mosfillimi, pushimi) të prokurorit Edison Ademi në lidhje me këta subjekte.

Nisur nga faktet si më sipër, Komisioni krijoi bindjen se, subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime që vijnë në kundërshtim me ligjin gjatë porositjes dhe blerjes së apartamentit, si dhe nuk është trajtuar në mënyrë preferenciale për blerjen e pasurisë.

### **1.4. Në lidhje me pasaktësitë në deklaratat periodike dhe në deklaratë n “Vetting”:**

**1.4.a** Në deklarimin periodik për vitin 2003, subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri.

<sup>6</sup> Sipas tabelës nr. 2 të këtij udhëzimi, ku paraqiten të dhëna të kostos së shitjes në tregun e lirë të apartamenteve për vitin 2003, rezulton se kosto e shitjes në lekë për m<sup>2</sup> të sipërfaqes së shfrytëzueshme në tregun e lirë në qytetin e Vlorës, është 48.845 lekë/m<sup>2</sup>.

<sup>7</sup> Kursi i këmbimit të datës 24.09.2003 1\$=123,69 lekë

<sup>8</sup> Shihni shpjegimet e subjektit pas dërgimit të rezultateve të hetimit, dërguar në rrugë elektronike nga subjekti në datën 29.03.2019, dhe me postë të protokolluar nga Komisioni me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 01.04.2019, në dosjen e Komisionit.

<sup>9</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 08.02.2019, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë; shkresë nr. \*\*\*prot., datë 06.02.2019, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Pogradec; shkresë nr. \*\*\*, datë 08.02.2019 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, në dokumentacionin bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3 në dosjen e Komisionit.

<sup>10</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 06.02.2019 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, në dokumentacionin bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3 në dosjen e Komisionit.



I pyetur për këtë mosdeklarim gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti, shpjegon<sup>11</sup> se nuk ka qenë shumë i qartë për procedurat dhe mënyrën e plotësimit të formularit, i cili ka qenë deklarimi i parë, duke sjellë si argument faktin se kontrata e prenotimit nuk është kontratë përfundimtare, dhe si e tillë është lehtësisht e revokueshme. Ai deklaroi se nuk ka pasur asnjë motiv për ta fshehur këtë pasuri.

Gjithashtu, pas kalimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore, subjekti pretendoi se deklarimi për vitin 2003 i është marrë në kundërshtim me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike” nga ana e ILDKPKI-së, pasi deri në korrik të vitit 2004 ai ka qenë oficer i policisë gjyqësore, dhe si i tillë nuk përfshihej në kategorinë e subjekteve deklaruere, të parashikuara në nenin 3 të këtij ligji. Pavarësisht këtij pretendimi, i cili vlerësohet si i bazuar, për shkak se gjatë vitit 2003, subjekti nuk ka qenë prokuror, pra nuk ka qenë subjekt deklarues, Komisioni çmon se, si Kushtetuta pika 4, në nenin Ç dhe nenin D të Aneksit të saj, ashtu dhe ligji nr. 84/2016, në nenet 30, 32 dhe 33 të tij, parashikojnë shtrirjen e procesit të rivlerësimit edhe në shqyrtimin e deklarimeve periodike të pasurisë, të kryera në të shkuarën nga subjektet e rivlerësimit, me qëllim që të identifikohen subjektet që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Në këtë kontekst, Komisioni vlerëson se, është në favor të një procesi rivlerësimi sa më objektiv për z. Edison Ademi, marrja në konsideratë e deklarimeve të tij, në deklaratën për vitin 2003, të cilat në thelb nuk kanë sjellë asnjë pasojë negative për subjektin e rivlerësimit.

Në lidhje me mosdeklarimin e pasurisë në deklarin periodik për këtë vit, Komisioni çmoi se, nisur nga fakti që për vitin 2003, subjekti ka deklaruar marrjen e kredisë për blerjen e kësaj pasurie, dhe në vijim ai e ka deklaruar këtë pasuri, (blerë me të ardhura të ligjshme), pasaktësia nuk është bërë me qëllim fshehjen e pasurisë, dhe për shkak të peshës së saj specifike, të mos merret në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes.

**1.4.b** Ka mospërputhje të deklarimeve në vitin 2004 dhe në deklaratë n “Vetting”, lidhur me vlerën dhe pjesën takuese të kësaj pasurie, pasi në deklaratën e pasurisë së vitit 2004, është deklaruar në vlerën 44.200 USD dhe me pjesë takuese 50 %, ndërsa, në deklaratën “Vetting” vlera e blerjes së kësaj pasurie është shënuar 45.000 USD (aq sa është në kontratën e porosisë), me pjesë takuese: 100 %.

Duke marrë në konsideratë sqarimet e subjektit lidhur me këto mospërputhje<sup>12</sup>, por edhe faktin se ato nuk kanë sjellë ndonjë pasojë, Komisioni i konsideron të papërfillshme, për t’u marrë në konsideratë gjatë vlerësimit përfundimtar.

**1.4.c** Në deklarin për vitin 2003, subjekti ka deklaruar si adresë banimi: Lagjja “\*\*\*\*”, Vlorë, por nuk ka deklaruar pasuri në pronësi ose në posedim me këtë adresë.

Me qëllim verifikimin nëse subjekti ka pasur në pronësi një pasuri në këtë adresë, si dhe shkaqeve që kanë çuar në mosdeklarimin e posedimit në deklarin për vitin 2003, Komisioni pyeti subjektin e rivlerësimit, i cili dha sqarimet përkatëse<sup>13</sup>, si dhe vuri në dispozicion

<sup>11</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2 dërguar nga subjekti, më datë 24.10.2018, në dosjen e Komisionit.

<sup>12</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2 dërguar nga z. Edison Ademi, më datë 24.10.2018, në dosjen e Komisionit.

<sup>13</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2 dërguar nga z. Edison Ademi në datën 24.10.2018, dhe dokumentet bashkëngjitur në dosjen e Komisionit.

deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 22.10.2018, të shtetases V. S. H, ortake e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., nga të cilat rezultoi se:

i) Në vitin 2002, midis shoqërisë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe babait të subjektit, z. Xh. A, është bërë një marrëveshje verbale për shitblerjen e një apartamenti me adresë në lagjen “\*\*\*\*”, Vlorë, në shumën 2.000.000 – 2.500.000 lekë (sipas deklaratës), shumë e cila është dorëzuar nga z. Xh. A, pa një dokument shkresor.

ii) Në këtë apartament banimi, subjekti ka jetuar së bashku me familjen gjatë vitit 2003. Në vitin 2004, duke qenë se subjektit i nevojitej hipoteka e banesës, me qëllim marrjen e një kredie, dhe shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., nuk ia mundësoi këtë, marrëveshja midis palëve u prish me vullnetin e tyre po në mënyre verbale, dhe palët u kthyen në gjendjen e mëparshme, duke iu kthyer z. Xh. A shuma prej 2.500.000 lekësh, shumë e cila është deklaruar nga subjekti si e ardhur ligjore në deklarinimin periodik për vitin 2004.

Nga sa më sipër, rezultoi se apartamenti në lagjen “\*\*\*\*”, Vlorë, nuk është deklaruar si pasuri në posedim në deklarinimin për vitin 2003, detyrim ligjor i parashikuar në germën “a”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, sipas te cilit, të gjitha subjektet deklaruese kanë pasur detyrimin e deklarimit të pasurive të paluajtshme dhe të drejtave reale mbi to.

Lidhur me këtë pasaktësi, nisur nga fakti që subjekti e ka deklaruar si adresë banimi këtë apartament për vitin 2003, si dhe nga fakti që janë deklaruar të ardhura nga shitja e tij në deklaratën periodike për vitin 2004, Komisioni vlerëson se mosdeklarimi i pasurisë, nuk është bërë me qëllim fshehjen e saj, dhe se pasaktësia në deklarinim nuk ka sjellë asnjë pasojë.

**1.4.d** Në deklarinimin për vitin 2004, subjekti ka deklaruar si adresë vendbanimi lagjen “\*\*\*\*”, Rr. “\*\*\*\*”, Vlorë, ndërkohë, në deklaratën për “Vetting”, deklaroi se apartamenti i prentuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., ka qenë në përdorim të tij, që nga viti 2004, me adresë: Rr. “\*\*\*\*”, Njësia Administrative Vlorë, \*\*\*.

Lidhur me këtë pasaktësi, pas sqarimeve të subjektit<sup>14</sup>, si dhe nga informacioni i vënë në dispozicion nga Bashkia Vlorë<sup>15</sup>, Komisioni, krijoi bindjen se bëhet fjalë për të njëjtën adresë, dhe se pasaktësia në deklarinim ka ardhur për shkak të ndryshimit të emërimit të Rr. “\*\*\*\*” në Rr. “\*\*\*\*”.

**1.4.e** Në deklarimet për vitet 2004 dhe 2012, nuk është deklaruar burimi i krijimit të kësaj pasurie, sipas detyrimit të parashikuar në nenin 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i cili përcakton, se subjektet deklaruese përveç deklarimit të pasurive të vitit paraardhës, kanë pasur edhe detyrimin e deklarimit të burimeve të krijimit të tyre.

Lidhur me këto pasaktësi, subjekti konfirmoi të njëjtat burime si ato të deklaruara në deklaratën “Vetting”, shitjen e banesës së prindërve të ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Vlorë, me vlerë 2.500.000 lekë, me gjithë orenditë të ndodhura në të, si dhe kredinë e marrë në “Alpha Bank” në shumën 30.000 USD. Në përfundim, Komisioni vlerësoi se, pasaktësitë në deklarimet për vitet 2004 dhe 2012 për mosdeklarim të burimit të krijimit të pasurisë, janë të një peshe specifike të vogël,

<sup>14</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2 dërguar nga z. Edison Ademi në datën 24.10.2018, në dosjen e Komisionit.

<sup>15</sup> Shihni shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\*prot., datë 08.01.2018, nga Bashkia Vlorë, në dosjen e Komisionit.

dhe si të tilla nuk ndikojnë në marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, për sa kohë që është vërtetuar që kjo pasuri është blerë me të ardhura të ligjshme.

**1.4.f** Në deklaratën “Vetting”, është deklaruar si burim shitja e apartamentit të prindërve në vitin 2000, në vlerën 2.500.000 lekë, së bashku me orenditë shtëpiake, ndërkohë që vlera e shitjes së pasurisë, sipas kontratës nr. \*\*\* rep., datë 14.10.2000, është 2.000.000 lekë, **fakt i cili e bën të pasaktë deklarinimin në deklaratën “Vetting”.**

Lidhur me vlerën e orendive shtëpiake, Komisioni vlerësoi që shuma prej 500.000 lekësh, e pretenduar si e fituar nga shitja e tyre, nuk duhet të merret në konsideratë, për shkak se nuk ka asnjë dokument shkresor që të vërtetojë në kohë reale, shitjen e orendive shtëpiake në shumën prej 500.000 lekësh, në mënyrë të shkëputur nga shitja e apartamentit. Kontrata e shitjes nr. \*\*\* rep., datë 14.10.2000, është i vetmi akt shkresor që vërteton shitjen e apartamentit. Subjekti pretendon se në atë periudhë pasuritë zakonisht shiteshin së bashku me orenditë që gjendeshin brenda tij. Nisur nga ky pretendim, logjikisht, apartamenti është shitur në vlerën 2.000.000 lekë, së bashku me orenditë brenda tij.

Përveç sa më sipër, deklaratat noteriale të prindërve dhe blerësve të pasurisë<sup>16</sup>, të bëra shumë kohë më pas, nuk mund të merren në konsideratë si prova që vërtetojnë vlerën e shitjes së orendive në shumën prej 500.000 lekësh<sup>17</sup>, pretenduar nga subjekti.

**1.5** Lidhur me burimin e deklaruar për blerjen e pasurisë, në shumën 45.000 USD, si burim krijimi i pasurisë, janë deklaruar:

**1.5.a** Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., datë 14.10.2000, nga shitja e banesës së prindërve nr. \*\*\*, në lagjen “\*\*\*\*”, Vlorë, në vlerën 2.500.000 lekë, me gjithë sendet të ndodhura në të.

Duke qenë se u vërtetua që në vitin 2002, subjekti ka paguar 2.500.000 lekë për blerjen e apartamentit të banimit në lagjen “\*\*\*\*”, Vlorë (arsyetuar më sipër në këtë vendim), si dhe nisur nga përgjigjet e pyetësorit të 2-të<sup>18</sup>, ku subjekti le të kuptohet se burimi i krijimit të pasurisë në lagjen “\*\*\*\*”, është nga shitja e apartamentit të prindërve në lagjen “\*\*\*\*”, Vlorë (në vitin 2000), Komisioni vlerëson se si burim për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi, nuk janë të ardhurat nga shitja e pasurisë prindërore në lagjen “\*\*\*\*”, Vlorë (sipas deklaramit të subjektit), por të ardhurat e përfituara nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., pas anulimit të marrëveshjes për blerjen e apartamentit të banimit në lagjen “\*\*\*\*” Vlorë, në shumën 2.500.000 lekë, të cilat subjekti i ka deklaruar si e ardhur në deklaratën periodike për vitin 2004.

Nisur nga sa më sipër, gjatë hetimit administrativ, është verifikuar nëse subjekti ka pasur mundësi financiare për të paguar shumën prej 2.500.000 lekësh, me qëllim blerjen e apartamentit në lagjen “\*\*\*\*”, Vlorë. Duke qenë se kjo vlerë është paguar në vitin 2002, është bërë analizë financiare për periudhën 1998-2002, si në tabelën më poshtë, nga ku rezulton se subjekti ka pasur mundësi për blerjen e apartamentit në lagjen “\*\*\*\*”, Vlorë .

<sup>16</sup> Shihni shpjegimet e subjektit pas dërgimit të rezultateve të hetimit, dhe dokumentacionin bashkëlidhur, dërguar në rrugë elektronike nga subjekti në datë 29.03.2019 dhe me postë të protokolluar nga Komisioni me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 01.04.2019, në dosjen e Komisionit.

<sup>17</sup> Shih vendimin nr. (JR) 6, datë 12.09.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për subjektin e rivlerësimit B.N, i cili është shprehur lidhur me fuqinë provuese të deklaratës noteriale, në kuptim pikë s 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 86/2014, të cilët kërkojnë dokumentacionin provues për burimin e krijimit të pasurisë në momentin e krijimit të kësaj pasurie.

<sup>18</sup> Shih përgjigjet e pyetësorit nr. 2 dërguar nga Edison Ademi në datë 24.10.2018 në dosjen e Komisionit.

<b>Përshkrimi</b>	<b>1998-2002</b>
Të ardhura nga subjekti, periudha 1998-2002	1.944.269
Të ardhura nga subjekti nga shitja apartamentit, Rr. "****"	1.500.000
<b>TOTAL TË ARDHURA</b>	<b>3.444.269</b>
Shpenzime jetese	-600.000
Paguar apartament, Lagjja "****"	-2.500.000
Blerë automjet tip "Rover"	-200.000
<b>TOTAL PAGUAR</b>	<b>-3.300.000</b>
<b>Diferenca</b>	<b>144.269</b>

Siç shihet në këtë tabelë, si e ardhur e përfituar nga shitja e apartamentit të banimit në lagjen "\*\*\*\*", Vlorë, në vitin 2000, në pronësi të prindërve, është konsideruar shuma prej 1.500.000 lekësh, dhe jo ajo e deklaruar prej subjektit në deklaratën "Vetting", me vlerë 2.500.000 lekë.

Pavarësisht se diferenca në vlerë n prej 1.000.000 lekësh, e pretenduar nga subjekti nga: (i) shitja e orendive shtëpiake; dhe (ii) nga motra e subjektit, znj. M. H, si një nga shitëset e pasurisë në lagjen "\*\*\*\*", Vlorë<sup>19</sup>, nuk kanë ndikuar në analizën financiare, si më sipër, Komisioni, gjen me vend të argumentojë shkaqet se përse këto shuma nuk janë marrë në konsideratë gjatë kësaj analize, duke hedhur poshtë pretendimet e subjektit, për shkak se:

i) Nuk ka asnjë provë që të vërtetojë shitjen e orendive shtëpiake në vlerën prej 500.000 lekësh. Kontrata e shitjes së pasurisë nr. \*\*\* rep., datë 14.10.2000, e vetmja provë shkresore në kohë reale, vërteton se vlera e përfituar nga shitja e pasurisë është 2.000.000 lekë<sup>20</sup>.

ii) Subjekti ka paraqitur deklaratat noteriale të prindërve dhe motrës së tij, znj. M. H, për të vërtetuar se ajo, nuk e ka marrë pjesën takuese të çmimit të shitjes së pasurisë (1/4). Këto akte, të redaktuara sot, nuk kanë fuqinë e provës për të vërtetuar një fakt që ka ndodhur vite më parë<sup>21</sup>.

**1.5.b.** Kontratë kredie nr. \*\*\*, me nr. \*\*\*, datë 07.11.2003, në "Alpha Bank", në vlerë n prej 30.000 USD (12 vjet).

Nga informacioni i dërguar nga "Alpha Bank"<sup>22</sup>, u konstatua se:

- Z. Edison Ademi me kontratën e kredisë nr. \*\*\*, datë 07.11.2003, i është aprovuar kredia nga "Alpha Bank" në shumën prej 30.000 USD. Në këtë kontratë (neni 1) pasqyrohet se qëllimi i saj është blerja e apartamentit në Vlorë.

- Me vërtetimin e datës 16.03.2016, vërtetohet se kredia në shumën 30.000 USD është disbursuar në datën 13.11.2003, dhe është likuiduar totalisht në datën 13.11.2015.

<sup>19</sup> Shihni kontratën me nr. \*\*\* rep., datë 14.10.2000, aneksin 4/1 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>20</sup> Shihni vendimin (JR) 11, datë 22.11.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pika 17.4.

<sup>21</sup> Shihni vendimin nr. (JR) 6, datë 12.09.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për subjektin e rivlerësimit B.N, i cili është shprehur lidhur me fuqinë provuese të deklaratës noteriale të mëvonshme, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 86/2014, të cilët kërkojnë dokumentacionin provues për burimin e krijimit të pasurisë, në momentin e krijimit të kësaj pasurie.

<sup>22</sup> Shihni dokumentet bashkëngjitur shkresës nr. \*\*\* prot., datë 04.11.2016, të "Alpha Bank" në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2018, në dosjen e Komisionit.

Në përfundim të hetimit administrativ, u konstatua se, sipas analizës financiare për vitin 2003 dhe 2004, pasqyruar në tabelën më poshtë, subjekti ka pasur mundësi financiare për të paguar çmimin e blerjes së pasurisë apartament banimi me sip. 130 m<sup>2</sup> në Vlorë, në shumën 45.000 USD.

	Përshkrimi	2003-2004
<b>1</b>	<b>PASURI</b>	<b>2.391.050</b>
	Apartament banimi 2+2 130 m <sup>2</sup> (45.000 USD)	4.891.050
	Shitur apartament banimi L. “***”, Vlorë, në vitin 2000	-2.500.000
<b>2</b>	<b>DETYRIME</b>	<b>3.260.700</b>
	Kredi për blerje banese “Alpha Bank” 30.000 euro	3.260.700
<b>3</b>	<b>PASURI NETO (1-2)</b>	<b>-869.650</b>
<b>4</b>	<b>TË ARDHURA TË DOKUMENTUARA</b>	<b>1.667.435</b>
	Të ardhura nga paga, subjekti	1.667.435
<b>5</b>	<b>SHPENZIME</b>	<b>1.433.855</b>
	Shpenzime jetese	964.286
	Shpenzime arredimi	100.000
	Interesa+principal kredi 30.000 euro “Alpha Bank”	369.569
	<b>DIFERENCA (TË ARDHURA – PASURI – SHPENZIME 4-3-5)</b>	<b>1.103.230</b>

#### 1.6 Lidhur me mënyrën e likuidimit të çmimit të blerjes së kësaj pasurie:

Në kontratën e porosisë nr. \*\*\*, datë 04.09.2003, deklarohet se çmimi i shitjes prej 45.000 USD, do të likuidohet nga porositësi me këste, në këtë mënyrë: (i) porositësi i likuidon sipërmarrësit, në momentin e firmosjes së kontratës, shumën prej 5.000 USD; (ii) kësti i dytë prej 20.000 USD, do të likuidohet nga porositësi në datën 01.10.2003; (iii) kësti i tretë prej 15.000 USD, do të likuidohet nga porositësi në datën 01.11.2003; dhe (iv) kësti i fundit prej 5.000 USD, do të likuidohet nga porositësi në momentin e dorëzimit të apartamentit.

Ndërkohë, në kontratën përfundimtare të shitjes, është deklaruar se çmimi i shitjes është likuiduar jashtë zyrës noteriale në *cash*, sipas mënyrës së parashikuar në kontratën e prenotimit të vitit 2003.

Nga hetimi administrativ, nuk rezultoi i vërtetuar likuidimi i çmimit të shitjes së pasurisë, në mënyrën e parashikuar në kontratën e prenotimit, si më sipër. Për këtë arsye, u pyet subjekti i rivlerësimit, të cilit iu kërkuan dokumente shkresore për të vërtetuar mënyrën e likuidimit të çmimit total të shitjes së pasurisë. Në përgjigjet e tij<sup>23</sup>, subjekti ka deklaruar se ka likuiduar totalisht çmimin e shitjes së pasurisë, por për një pjesë të pagesave nuk disponon dokumente shkresore, pasi nuk ka pasur detyrim ligjor për t’i mbajtur. Gjithashtu, subjekti vuri në dispozicion dokumente shkresore pranë “Alpha Bank”, dega Vlorë, si dhe deklarata noteriale

<sup>23</sup> Shihni shpjegimet e subjektit pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe dokumentacionin bashkëlidhur, dërguar në rrugë elektronike nga subjekti, më datë 29.03.2019, dhe me postë të protokolluar nga Komisioni me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 01.04.2019, në dosjen e Komisionit.

të shtetasit B. R, administrator i shoqërisë<sup>24</sup>, si dhe të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.,<sup>25</sup> nga të cilat u konstatua se:

- Me kontratë prenotimi për shitje nr. \*\*\*, datë 04.09.2003, është paguar shuma prej 5.000 USD.

- Sipas urdhërkalimit<sup>26</sup> të “Alpha Bank”, dega Vlorë, të datës 14.11.2003 (një ditë pas disbursimit të kredisë, datë 13.11.2003), është transferuar shuma prej 18.200 USD, nga z. Edison Ademi te shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me përshkrimin “këst për blerje apartamenti”.

- Sipas urdhërkalimit<sup>27</sup> të “Alpha Bank”, dega Vlorë, të datës 03.03.2004, (disa muaj pas disbursimit të kredisë, datë 13.11.2003) është transferuar shuma prej 5.000 USD nga z. Edison Ademi te shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me përshkrimin “këst për blerje apartamenti”.

Për sa më sipër, u vërtetua me dokumente shkresore pagimi pjesërisht i çmimit të blerjes së pasurisë, konkretisht i shumës prej 28.200 USD. Për pjesën e mbetur prej 16.800 USD, nuk u vërtetua me dokumente shkresore që kjo shumë të ketë kaluar në llogari të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. Lidhur me këtë, administratori i shoqërisë, z. B. R, deklaroi se:<sup>28</sup> “... një pjesë e çmimit të blerjes janë paguar në zyrat e shoqërisë me mandate arkëtimi të firmosur nga të dy palët... Në lidhje me dokumentacionin e likuidimit, nuk ekziston, pasi për shkak të kohës së gjatë dhe mospasjes së asnjë kontradite, janë nxjerrë jashtë përdorimit...”

Për sa i përket shumës së pavërtetuar me dokumente shkresore prej 16.800 eurosh, Komisioni, çmon se pretendimi i subjektit se kjo shumë është likuiduar prej tij, duhet pranuar, duke marrë në konsideratë faktet si vijojnë:

- i) subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për të paguar këtë shumë;
- ii) subjekti e ka deklaruar kredinë prej 30.000 USD për blerje apartamenti, që në deklarimin për vitin 2003, kredi, e cila siç rezulton nga pagesat e bëra pranë “Alpha Bank”, është përdorur për likuidimin e çmimit të blerjes së kësaj pasurie;
- iii) kontrata e kredisë nr. \*\*\*, datë 07.11.2003, pasqyron saktë se qëllimi i marrjes së kredisë, është blerja e një apartamenti në Vlorë, fakt i cili ka ndodhur në realitet;
- iv) deklaratat noteriale të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe administratorit të saj, edhe pse ato nuk i përkasin periudhës reale, duhen pranuar, duke marrë të mirëqenë faktin se, jo gjithmonë në periudhën për të cilën bëhet fjalë (vitet 2000), janë përpiluar fatura apo deklarata shkresore, për të vërtetuar likuidimin e çmimit të shitjes së pasurive;
- v) nuk ka fakte, rrethana, apo pretendime nga pala shitëse që të tregojnë se subjekti nuk e ka paguar tërësisht çmimin e blerjes së pasurisë sipas kontratës së porosisë.

**2. Orendi dhe mobilje banese, në vlerën 800.000 lekë, në pjesë takuese 50 %, pa u deklaruar burimi i krijimit.**

**2.1 Nga deklaratimet periodike, ka rezultuar se:**

---

<sup>24</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 3, dërguar nga subjekti, më datë 10.02.2019, dhe dokumentacionin bashkëlidhur, në dosjen e Komisionit.

<sup>25</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., protokolluar nga Komisioni me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.12.2018, në dosjen e Komisionit.

<sup>26</sup> Shihni dokumentin e urdhërkalimi të “Alpha Bank”, dega Vlorë, të datës 14.11.2003, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3, në dosjen e Komisionit.

<sup>27</sup> Shihni dokumentin e urdhërkalimi të “Alpha Bank”, dega Vlorë, të datës 14.11.2003, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr.3, në dosjen e Komisionit.

<sup>28</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., protokolluar nga Komisioni me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.12.2018, në dosjen e Komisionit.

- i) në deklarin për vitin 2005, është deklaruar kredi për mobilim nga “Raiffeisen Bank”, dega Vlorë, me afat 4 vjet, në vlerën 700.000 lekë;
- ii) në deklaratën “Vetting” janë deklaruar sende dhe mobilje banese me vlerë 800.000 lekë.

Nga hetimi administrativ u vërtetua se, me kontratën e kredisë së datës 15.12.2005, subjekti ka përfituar nga “Raiffeisen Bank”, një kredi në shumën 700.000 lekë për mobilim. Kjo kredi është mbyllur në datën 16.12.2009.<sup>29</sup>

Në përgjigjet e pyetësorit të parë<sup>30</sup>, subjekti ka konfirmuar vlerën e përafërt të mobilimeve prej 800.000 lekësh, duke sqaruar se nuk ka bërë rinovime, pasi prej katër vitesh është më shumë i larguar nga kjo banesë dhe se nuk disponon fatura për të vërtetuar shpenzime mobilimi. Subjektit i është kërkuar gjithashtu të saktësojë periudhën se kur është bërë arredimi. Në shpjegimet<sup>31</sup> e tij, ai ka sqaruar se: “.. arredimi bazë tij i përket dy viteve të para, 2004 – 2005...”

Duke qenë se subjekti nuk ka specifikuar shumat përkatëse në secilin vit, dhe kredia është marrë në vitin 2005, shpenzimet për arredim në shumën prej 700.000 lekësh i janë llogaritur për këtë vit, duke konsideruar se këto shpenzime janë bërë pikërisht me kredinë prej 700.000 lekësh, të marra nga “Raiffeisen Bank”, ndërsa shpenzimet në shumën prej 100.000 lekësh, i janë llogaritur gjatë vitit 2004, vit në të cilin subjekti nuk ka rezultuar me diferenca të pajustificuara.

Lidhur me mosdeklarimin e burimit të krijimit në deklaratën “Vetting”, Komisioni çmon se ka një pasaktësi në deklarin nga ana e subjektit, për shkak të detyrimit ligjor të përcaktuar në shtojcën 2, të ligjit nr. 84/2016.

**3.** Automjet tip “Mercedes Benz C200”, me targë \*\*\*, viti i prodhimit 2004. Burimi i krijimit është nga këmbimi me automjetin tip “Mercedes Benz E 270”, me targë \*\*\*, i vitit 2003, me kontratë shkëmbimi automjeti nr. \*\*\*, datë 22.10.2015. Pjesa takuese: 100 %.

Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se :

DPSHTRR-ja<sup>32</sup> konfirmon autoveturat në pronësi të z. Edison Xh. Ademit, si vijojnë:

- i) aktualisht ka në pronësi automjetin me targë \*\*\* (blerë pas deklaratës “Vetting”<sup>33</sup>).
- ii) ka pasur në pronësi mjetin me targë \*\*\*, nga data 22.10.2015 deri në datën 25.05.2017 (shitur pas deklaratës “Vetting”<sup>34</sup>).
- iii) ka pasur në pronësi mjetin me targë \*\*\*, nga data 06.08.2012 deri në datën 22.10.2015 (këmbyer me mjetit me targë \*\*\*).

Nga informacioni i marrë nga ky institucion, u vërtetua se mjeti me targë \*\*\*, deklaruar për vetting, është përfituar nga subjekti në këmbim të mjetit në pronësi të tij me targë \*\*\*, sipas kontratës së këmbimit nr. \*\*\*, datë 22.10.2015. Këtë mjet subjekti e ka deklaruar saktësisht në deklarin periodik për vitin 2015 dhe deklaratën “Vetting” si në pikën 3 (iii) më sipër. Vlera

<sup>29</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., 10.04.2018, nga “Raiffeisen Bank” në dosjen e Komisionit.

<sup>30</sup> Shihni përgjigjen e pyetjes nr. 11 në përgjigjet e pyetësorit të parë, dërguar nga subjekti me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.04.2018, nga Prokuroria pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Sarandë, në dosjen e Komisionit.

<sup>31</sup> Shihni përgjigjet e pyetjeve shtesë të pyetësorit nr. 3, dërguar nga subjekti në datën 16.02.2019, në dosjen e Komisionit.

<sup>32</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 15.10.2018, nga DPSHTRR-ja në dosjen e Komisionit.

<sup>33</sup> Shihni kontratën e blerjes nr. \*\*\*, datë 01.03.2017, bashkëngjitur shkresës nr. \*\*\*prot., datë 15.10.2018, nga DPSHTRR-ja në dosjen e Komisionit.

<sup>34</sup> Shihni kontratën nr. \*\*\*, datë 23.05.2017, bashkëngjitur shkresës nr. \*\*\*prot., datë 15.10.2018, nga DPSHTRR-ja në dosjen e Komisionit.

e këtij mjeti nuk është përfshirë në analizën financiare, për shkak se është fituar me këmbim, dhe jo me blerje.

### 3.1 Lidhur me mjetin me targë \*\*\*, objekt këmbimi me mjetin me targë \*\*\*:

Gjatë hetimit administrativ rezultoi se, është deklaruar nga subjekti në deklarin periodik për vitin 2012, si autoveturë me blerje (zhdoganuar, targuar) me vlerë 800.000 lekë. Me kërkesë të Komisionit, subjekti deklaroi <sup>35</sup>: “...bëhet fjalë pikërisht për automjetin ‘Daimler Crysler’ me nr. shasie \*\*\*, i përfituar nga vëllai i subjektit, z. A. A...”

DPSHTRR-ja<sup>36</sup> ka vënë në dispozicion një faturë shitjeje në gjuhën angleze, të datës 20.07.2012, me të cilën vërtetohet se z. A. A i ka shitur z. Edison Ademit, mjetin tip “Daimler Crysler”, me nr. shasie \*\*\* në shumën 4.000 GBP. Pas regjistrimit, ky mjet ka marrë targën \*\*\*. Sipas deklarin periodik për vitin 2012, vlera e blerjes, + zhdoganim + targim, është 800.000 lekë.

Gjatë analizës financiare për vitin 2012, si në tabelën më poshtë (pasi u morën në konsideratë pretendimet e subjektit pas kalimit të barrës së provës, në lidhje me analizën financiare) rezultoi se subjekti, nuk ka pasur mundësi financiare për të blerë këtë automjet, për shkak të një difference të pajustificuar në shumën prej 886.863 lekësh.

	Përshkrimi	2012
<b>1</b>	<b>PASURI</b>	<b>800.000</b>
	Autoveturë *** “Daimler Crysler”	800.000
<b>2</b>	<b>TË ARDHURA TË DOKUMENTUARA</b>	<b>1.883.961</b>
	Të ardhura nga paga subjekti	969.362
	Të ardhura nga paga bashkëshortja	561.991
	Të ardhura nga vëllai emigrant (dhurime)	
	Të ardhura babai (pension)	260.750
	Të ardhura nëna (pension)	91.858
<b>3</b>	<b>SHPENZIME</b>	<b>1.986.267</b>
	Shpenzime jetese	964.286
	Interesa kredi 30,000 euro “Alpha Bank”	311.225
	Interesa kredi 870,000 lekë “Raiffeisen Bank”	245.635
	Tokë bujqësore me kontratë qiraje në Nartë 0,5 Ha	5.000
	Shpenzime me kartë krediti	63.316
	Shpenzime udhëtimi TIMS	396.805
<b>4</b>	<b>KURSIME</b>	<b>-15.443</b>
	<b>DIFERENCA (TË ARDHURA – PASURI - SHPENZIME 2-1-3-4)</b>	<b>-886.863</b>

Lidhur me këtë autoveturë, pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi se, ajo është dhuratë nga vëllai i tij, shtetasi A. A, dhe për këtë arsye vlera e saj, nuk duhet të përfshihet si shpenzim gjatë analizës financiare. Gjithashtu, ai paraqiti deklaratën noteriale të këtij shtetasi

<sup>35</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2 dërguar nga Edison Ademi në datën 24.10.2018, në dosjen e Komisionit.

<sup>36</sup> Shihni shkresën dërgim dokumentacioni nr. \*\*\*, datë 25.04.2018, të DPSHTRR-së në dosjen e Komisionit.



nr. \*\*\*, datë 26.03.2019<sup>37</sup>, sipas të cilës, mjeti autoveturë tip “Mercedes E 270 CDI Elegance Auto”, i ka kaluar vëllait, z. Edison Ademi, me dhurim.

Për sa i takon këtij pretendimi, Komisioni çmoi se, deklarata e datës 26.03.2019 e shtetasit A. A, nuk mund të konsiderohet si provë për të kundërshtuar deklarinimin e subjektit në deklaratën periodike të vitit 2012<sup>38</sup>, ku figuron të jetë shkruar: “Autoveturë me blerje (zhdoganuar, targuar) me vlerë 800.000 lekë”. Për këtë arsye, në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni e konsideroi të pabazuar deklarinimin e subjektit pas kalimit të barrës së provës, dhe vlera e mjetit është përfshirë si shpenzim në analizën financiare të vitit 2012 (si më sipër).

**4.** Llogari për fëmijë nr. \*\*\*, çelur në datën 02.04.2014, në emër të E. A në “Raiffeisen Bank” (kursime, dhurime të vogla), në vlerën prej 1.051.239 lekësh, pjesa takuese: 50 %. “Raiffeisen Bank” e konfirmon këtë llogari bankare<sup>39</sup>.

**5.** Llogari, nr. \*\*\*, çelur në datën 01.03.2005, në “Raiffesien Bank” të z. Edison Ademi (800.000 lekë nga kredia e vitit 2016 dhe paga), në vlerën prej 893.000 lekësh, në pjesë takuese 50 %. “Raiffeisen Bank” e konfirmon këtë llogari<sup>40</sup>.

**6.** Llogari depozite, nr. \*\*\*, të Edison dhe H. A në “NBG” (kursime periodike dhe 1.000 USD dërguar nga halla, F. H, SHBA, për operacionin e babait në vitin 2016), e hapur në datën 09.05.2005. Vlera: 2056,04 (USD); pjesa takuese: 50 %. “NBG-ja” e konfirmon këtë llogari<sup>41</sup>.

**7.** Gjendje *cash* (kursime, kontribute nga emigracioni, pjesë nga kreditë), në vlerën: 10.000 euro, pjesa takuese: 100 %. Gjatë analizës financiare ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për likuiditetin në *cash*, pasi në vitet e krijimit të kësaj shume, subjekti ka rezultuar me diferenca të pajustificuara me të ardhura të ligjshme.

**8.** Qiramarrje sipas certifikatës për dhënie me qira, me datë 01.06.2012 dhe kontratës nr. \*\*\*, datë 03.05.2012, të tokës bujqësore në Nartë, Vlorë, me sip. 0.5 ha (e pashfrytëzuar, e varfër, jopjellore, kripore, praktikisht pa interes dhe marrëveshje e pamaterializuar). Vlera e paguar si qira vjetore: 5.000 lekë (totali: 25.000 lekë ); pjesa takuese: 100 %.

**8.1** Kjo marrëdhënie qiramarrjeje është deklaruar në deklaratat periodike si vijon:

i) Në deklarinimin për vitin 2012, deklarohet tokë bujqësore, 0.5 ha, fshati Nartë, rrethi Vlorë, me kontratë qiraje. Vlera: 5.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

ii) Në deklaratën “Vetting”, sipas përshkrimit në pikën 8 si më sipër.

Nuk ka mospërputhje ose pasaktësi në deklarime.

<sup>37</sup> Shihni shpjegimet e subjektit pas dërgimit të rezultateve të hetimit, dhe dokumentacionin bashkëlidhur, dërguar në rrugë elektronike nga subjekti në datën 29.03.2019, dhe me postë të protokolluar nga Komisioni me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 01.04.2019, në dosjen e Komisionit.

<sup>38</sup> Shihni vendimin nr. (JR) 6, datë 12.09.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për subjektin e rivlerësimit B.N, i cili është shprehur lidhur me fuqinë provuese të deklaratës noteriale të mëvonshme, në kuptim pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 86/2014, të cilët kërkojnë dokumentacionin provues për burimin e krijimit të pasurisë, në momentin e krijimit të kësaj pasurie.

<sup>39</sup> Shihni shkresën e “Raiffeisen Bank” me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.01.2017, depozituar në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>40</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\*, datë 10.04.2018 të “Raiffeisen Bank” në dosjen e Komisionit.

<sup>41</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\*, datë 05.04.2018, të “NBG-së ” në dosjen e Komisionit.

Lidhur me procedurat e dhënies me qira të kësaj pasurie, nga verifikimi i dokumentacionit që subjekti ka vënë në dispozicion të ILDKPKI-së<sup>42</sup>, informacioni i marrë nga Komuna Qendër, Vlorë dhe Njësia Administrative Qendër, Bashkia Vlorë<sup>43</sup>, rezultoi se:

i) Me aktin nr. \*\*\*, datë 03.05.2012, midis shtetasit Edison Ademi dhe qiradhënësit Komuna Qendër Vlorë, është lidhur kontratë noteriale qiraje për dhënien me qira të pasurisë, tokë bujqësore, me sip. 5000 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, ZK \*\*\*, Vlorë; në vlerën: 10.000 lekë në vit për hektar, me afat 99 vjet.

ii) Kontrata është lidhur në formën e kërkuar nga ligji (dispozitat e Kodit Civil për kontratën e qirasë, neni 801 e në vijim), në bazë të vendimit nr. 6, datë 15.11.2011, me Komunën Qendër Vlorë, për një afat nga 18.04.2012 - 18.04.2111, i cili mund të zgjatet me marrëveshje të palëve. Objekti i kontratës është dhënia me qira e tokës bujqësore, e pandarë, pasuri shtetërore, për aktivitet sipas planit të biznesit të paraqitur nga qiramarrësi dhe të miratuar nga bordi i dhënies së tokës me qira të Komunës Qendër, për prodhim fidanësh dhe plantacion ullinjsh.

iii) Në datën 01.06.2012, është lëshuar certifikata për dhënie me qira, në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Edison Ademi, lëshuar nga ZVRPP-ja Vlorë.

iv) Qiramarrësi ka paguar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë.

**8.2.** Në lidhje me konfliktin e interesit, gjatë hetimit administrativ, u konstatua se:

Në datën e lidhjes së kontratës, 03.05.2012, subjekti ka qenë prokuror, dhe ligji nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, nuk e ka ndaluar të lidhë kontratën e qirasë.

Me ligjin nr. 44/2014, datë 24.04.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, u parashikua ndalimi ligjor se: “..., gjyqtarët e prokurorët në nivelin e gjykatës së shkallës së parë e në atë të apelit, ..., nuk mund të lidhin kontrata ose nënkontrata me asnjë institucion publik”. Në kohën e hyrjes së këtij ligji në fuqi, ishte lidhur kontrata e qirasë midis subjektit dhe Komunës Qendër Vlorë (datë 03.05.2012), ndërkohë, subjekti ka vijuar të ushtrojë detyrën e prokurorit, edhe pas hyrjes në fuqi të tij (datë 03.06.2014).

Sipas ILDKPKI-së,<sup>44</sup> institucioni kompetent për konfliktin e interesit, por dhe në përfundim të hetimit paraprak nga ana e Komisionit, është konstatuar se subjekti ka shkelur dispozitat e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, për periudhën nga data 03.06.2014 dhe në vazhdim, dhe gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

Pas kalimit të barrës së provës<sup>45</sup>, subjekti i rivlerësimit pretendoi se nuk është në situatën e konfliktit të interesit, për shkaqet e përmbledhura shkurtimisht si vijojnë:

<sup>42</sup> Shihni aneksin nr. \*\*\*, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>43</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2018, nga Njësia Administrative Qendër, Bashkia Vlorë në dosjen e Komisionit.

<sup>44</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.01.2018, për dërgimin e aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit, Edison Ademi nga ILDKPKI-ja.

<sup>45</sup> Shihni shpjegimet e subjektit pas dërgimit të rezultateve të hetimit, dhe dokumentacionin bashkëlidhur, dërguar në rrugë elektronike nga subjekti në datën 29.03.2019, dhe me postë, të protokolluar nga Komisioni me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 01.04.2019, në dosjen e Komisionit.

- Ligji nuk ka efekt prapaveprues, pra, ndryshimet ligjore të vitit 2014, nuk kanë efekte për kontratat e lidhura më parë.
- Marrëdhënia e qiramarrjes ka qenë marrëdhënie e një lloji të veçantë dhe interesi bazë ka qenë ai i mirëmbajtjes dhe i shfrytëzimit të tokës. Sipas tij, nuk ka një interes në marrjen me qira të tokës (të paktën ende), prandaj nuk ka se si të ketë konflikt interesi.
- Pala e mundshme e interesuar për zgjidhjen e kontratës (Komuna Qendër Vlorë), nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për prishjen e kontratës.
- Nuk ka asnjë reagim institucional për konflikt interesi, përfshirë dhe ILDKPKI-në.
- Ka një dispozitë konkrete që shmang kufizimet edhe në rastin e ndryshimeve ligjore që janë bërë, duke iu referuar pikës 4, të nenit 21, të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005.

### 8.3. Arsyetim ligjor:

Me qëllim arritjen e një përfundimi sa më të bazuar në fakte e në ligj, lidhur me situatën e konfliktit të interesit, Komisioni i është referuar udhëzimit nr. 3, datë 16.05.2007, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” dalë në bazë të nenit 4, të VKM-së nr. 531/1998<sup>46</sup>, i cili parashikon një procedurë të detajuar që duhet të ndiqet në lidhje me dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara.

Sipas këtij udhëzimi, dy kushtet për përdorimin e tokës me qira për 99 vjet janë: (i) përdorimi dhe shfrytëzimi i tokës për veprimtari bujqësore dhe blegtorale; si dhe (ii) qiramarrësi është i detyruar të zbatojë planin e biznesit për tokën e dhënë me qira. Në të kundërt, kjo kontratë shfuqizohet, sipas parashikimit në kontratë.

Për sa i përket përmbushjes së kushteve të kontratës së qirasë nga ana e subjektit, gjatë hetimit administrativ, u konstatua se:

i) Në deklaratën “Vetting” subjekti, z. Edison Ademi, ka deklaruar se toka bujqësore e marrë me qira është e pashfrytëzuar, e varfër, jopjellore, kripore, praktikisht pa interes dhe marrëveshje e pamaterializuar.

ii) Në deklaratimet periodike për vitet 2012-2016, nuk janë deklaruar të ardhura nga ky biznes dhe as investime të kryera.

iii) Nga të dhënat që ILDKPKI-ja ka marrë nga QKB-ja<sup>47</sup>, rezulton se subjekti i rivlerësimit, nuk figuron të jetë i pajisur me NIPT si person fizik, apo të zotërojë kuota/aksione në shoqëri tregtare.

iv) Në informacionin e vënë në dispozicion nga Komuna Qendër Vlorë, Njësia Administrative Qendër dhe Bashkia Vlorë, edhe pse vërtetohet që subjekti ka paguar rregullisht detyrimet (qiratë) që rrjedhin nga kontrata, nuk rezulton që për kete kontratë të ketë një plan biznesi.

v) Nga informacioni i degës së ALUIZNI-t<sup>48</sup>, si dhe printimet nga interneti të *ortofotos* së përfituar nga fotografimi ajror i pasurisë, me nr. pasurie \*\*\*, datë 14.04.2007, fotot e printime të vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, nuk ka të dhëna që të tregojnë se mbi këtë pasuri janë kryer investime.

<sup>46</sup> I cili ka dalë në zbatim të ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998, “Për tokat bujqësore të pandara” dhe VKM-në nr. 531, datë 21.08.1998, “Për tokat bujqësore të pandara”.

<sup>47</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\*prot., datë 02.08.2017, të QKB-së në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>48</sup> Shihni shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 08.01.2019 nga ALUIZNI dhe CD-në bashkëlidhur në dosjen e Komisionit.

vi) I pyetur në lidhje me detyrimin për të zbatuar një plan biznesi dhe shfuqizimin e kontratës nëse ky plan nuk zbatohet (sipas ligjit dhe parashikimit në kontratë), subjekti deklaroi se<sup>49</sup>: “... nuk e kam parë të arsyeshme të disponoj planin e biznesit... por nga sa më kujtohet, duhej të ishte në funksion dhe të planit të përgjithshëm të zonës, praktikisht përpjekje për zhvillimin e kulturës së ullirit...” Në lidhje me zbatimin e këtij plani, ai deklaroi se: “...ka bërë disa përpjekje, me këmbënguljen e babait të tij, me shpenzime modeste për mbjelljen e fidanëve të vegjël të ullinjve, nga të ardhurat familjare në Shqipëri dhe ato që dërgonte vëllai, por duke marrë fidanë pa pagesë dhe që nuk kanë vlerë të konsiderueshme... deri tani vetëm sa po kontribuojnë për përmirësimin e tokës, dhe i ati ka mbjellë përsëri ca fidanë, por që ende kanë shumë vështirësi në rritje...” Në lidhje me shfuqizimin e kontratës në rast të moszbatimit të një plani biznesi, ai deklaroi se: “... nëse pala tjetër nuk është e kënaqur me respektimin e kontratës mund të veprojë, është e drejta e saj, nuk e di kush e pengon, nuk mund të jem unë i interesuari për të prishur kontratën...” Në lidhje me pagesat e qirasë, ai deklaroi se vazhdon t’i paguajë qiratë, duke paraqitur dhe kopje të mandatarkëtimeve. Shpjegimet e subjektit, përputhen me dokumentet e administruara gjatë hetimit administrativ.

Nga të gjitha sa më sipër, referuar edhe pretendimeve të subjektit, në përfundim të procesit të rivlerësimit, u konstatua se: (i) mbi tokën e marrë me qira nuk ka pasur dhe nuk është realizuar një plan biznesi, si dhe nuk janë kryer investime; (ii) kontrata e qirasë nuk është zgjidhur as me kërkesë të Komunitetit Nartë, e cila ka pasur detyrim ligjor për shkak të moszbatimit të planit të biznesit, dhe as me kërkesën e subjektit të rivlerësimit, pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të ligjit të vitit 2014; (iii) sipas parashikimit të pikës 4, të nenit 21, të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, ku parashikohen disa përjashtime nga ndalimi i lidhjes së kontratave, në asnjë rast nuk parashikohet përjashtimi i rastit konkret.

Pavarësisht këtyre konstatimeve, Komisioni çmon se, në kohën e lidhjes së kontratës së qirasë, datë 03.05.2012, ligji nuk e ka ndaluar subjektin që të hyjë në marrëdhënien e qiramarrjes sipas kushteve të përcaktuara në kontratë. Në këtë kuptim, subjekti nuk ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit në momentin e lidhjes së kontratës, por në vijim, ka qenë në tejkalim të pengesës ligjore të parashikuar në ndryshimet e vitit 2014: “... gjyqtarët e prokurorët në nivelin e gjykatës së shkallës së parë e në atë të apelit, nuk mund të lidhin kontrata ose nënkontrata me institucione publike”.

Është e vërtetë se deri sot, toka objekt i kontratës së qirasë, nuk është përdorur për veprimtari bujqësore dhe blegtorale, dhe as nuk është realizuar një plan biznesi, po kjo nuk do të thotë që keto nuk mund të ndodhin në të ardhmen, derisa kontrata e qirasë të jetë në fuqi. Duke pasur në konsideratë se qëllimi i ligjit është parandalimi dhe shmangia e konfliktit të interesit, Komisioni çmon se, subjekti i rivlerësimit, ka pasur mundësinë dhe duhet të kishte marrë masat, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesave, pas ndryshimeve në ligj në vitin 2014, duke kërkuar zgjidhjen e kontratës, gjë që nuk e ka bërë, duke vijuar të jetë në një marrëdhënie, që ligji në fuqi, nuk e lejon.

Në përfundim, Komisioni vlerësoi se edhe pse subjekti nuk ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit në kohën e lidhjes së kontratës, nuk është në etikën e një prokurori vijimi i një marrëdhënieje juridike, të cilin ligji aktual e ndalon. Ky fakt është mbajtur në konsideratë, gjatë vlerësimit profesional, në drejtim të vlerësimit të etikës të subjektit të rivlerësimit.

---

<sup>49</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2 dërguar nga z. Edison Ademi në datën 24.10.2018, në dosjen e Komisionit.

Lidhur me evidentimin e faktit nëse subjekti është trajtuar në mënyrë preferenciale nga Komuna Qendër Vlorë, gjatë hetimit administrativ nuk rezultoi që subjekti të ketë pasur në shqyrtim çështje ku pjesëmarrëse në hetime apo gjykime ka qenë Komuna Qendër Vlorë, ose kryetari i saj, z. F. B<sup>50</sup>.

## **DETYRIME FINANCIARE**

Në deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar kontratë kredie pa hipotekë me datë 06.05.2016, pranë “Raiffeisen Bank”, në shumën 2.000.000 lekë, me afat 84 muaj, kësti mujor 30.087,69 lekë, dhënë kredimarrësit Edison Ademi dhe A. A, me qëllim për blerjen e ndonjë shtëpie tjetër, makine apo prone në interes të familjes, sipas okazionit dhe momentit. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer, deri në datën e plotësimit të deklaratës “Vetting”, është 1.876.348,57 lekë.

“Raiffeisen Bank”<sup>51</sup>, e konfirmoi këtë kredi në emër të subjektit, z. Edison Ademi, me detyrim të pashlyer deri në datën 10.04.2018, në shumën 1.574.921,30 lekë.

## **DEKLARIMET E PERSONAVE TË LIDHUR:**

**1.** Bashkëshortja e subjektit, znj. A. A, ka plotësuar autorizimin sipas të cilit nuk ka pasur pasuri veçmas në emër të saj.

Gjatë hetimit administrativ, rezultoi se:

- Nga përgjigjet e zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme<sup>52</sup>, në emër të znj. A. A, nuk rezulton e regjistruar ndonjë pasuri e paluajtshme.

- DPSHTRR-ja<sup>53</sup> nuk konfirmon automjet të regjistruar në emër të znj. A. A.

- Nga verifikimi i llogarive bankare, ka rezultuar se nuk janë deklaruar në deklaratat periodike ndër vite, disa likuiditete në llogaritë bankare të bashkëshortes së subjektit, znj. A. A, pranë “Tirana Bank”<sup>54</sup>, “BKT-së”<sup>55</sup> dhe “Pro Credit Bank”<sup>56</sup>.

- Lidhur me këto llogari, pas verifikimit, u konstatua se likuiditetet e padeklaruara janë me burim të ardhurat nga pagat, si rrjedhim, pasaktësitë në deklarime nuk kanë sjellë asnjë pasojë dhe, si të tilla, nuk janë marrë në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes.

**2.** Nëna e subjektit, znj. H. A., ka plotësuar deklaratën e pasurisë së personit të lidhur, pasi ka deklaruar se disponon pasuri veçmas të regjistruar në emrin e saj, duke deklaruar:

<sup>50</sup> Shihni vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 15.10.2018, i lëshuar nga prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

<sup>51</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\*, datë 10.04.2018, të “Raiffeisen Bank”, në dosjen e Komisionit.

<sup>52</sup> Shihni përgjigjet e zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në dosjen e Komisionit.

<sup>53</sup> Shihni shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\*, datë 10.04.2018, nga DPSHTRR-ja, në dosjen e Komisionit.

<sup>54</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.04.2018, të “Tirana Bank” në dosjen e Komisionit.

<sup>55</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.04.2018, të “BKT-së”, në dosjen e Komisionit.

<sup>56</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\*, datë 11.04.2018, të “ProCredit Bank”, në dosjen e Komisionit.

- Llogari depozite, Edison dhe H. A, në “NBG” (kursime periodike dhe 1.000 USD dërguar nga halla, F. H, SHBA, për operacionin në vitin 2016), hapur në datën 09.05.2005, në shumën 2056.04 USD. Pjesa takuese: 50 %. “NBG-ja”<sup>57</sup> e konfirmon këtë llogari bankare.

- Llogari depozite tek “Alpha Bank”, në datë 22.12.2015 (kursime, kontribute emigracioni, dhurime të vogla), deklaruar në deklaratat vjetore dhe në deklaratën “Vetting”, në shumën prej 3.050 eurosh. Pjesa takuese: 100 %. “Alpha Bank”<sup>58</sup> e konfirmon këtë llogari.

**3.** Babai i subjektit, z. Xh. A, ka plotësuar deklaratën e pasurisë së personit të lidhur, pasi ka deklaruar se disponon pasuri veçmas të regjistruar në emrin e tij, duke deklaruar llogari depozite në “Credins Bank”, në datë 18.12.2014 (kursime mbledhur nga të afërm për ceremoniale, kontribute emigracioni), në shumën 348.160 lekë; pjesa takuese: 100 %. “Credins Bank”<sup>59</sup> e konfirmon këtë llogari bankare.

Ndërkohë, gjatë hetimit administrativ, u konstatua se “Credins Bank”<sup>60</sup> konfirmon edhe llogarinë me nr. \*\*\* në emër të Xh. A ose M. H, me gjendje prej 409.569 lekësh, në datën 27.01.2017, llogari e cila nuk është deklaruar nga babai i subjektit, z. Xh. A, në deklaratën “Vetting”, **duke e bërë këtë deklaram të pasaktë, për shkak të detyrimit ligjor parashikuar në shtojcën nr. 2, të ligjit nr. 84/2016.** Por, duke konsideruar se kjo llogari bankare është lehtësisht e verifikueshme, Komisioni çmoi se mosdeklarimi i saj, nuk është bërë me qëllim fshehjeje pasurie dhe shuma prej 409.569 lekësh është marrë në konsideratë gjatë analizës financiare për vitet 2015 dhe 2016.

**4.** Vëllai i subjektit, z. A. A, në autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ka deklaruar se nuk disponon pasuri veçmas të regjistruar në emrin e tij.

Gjatë hetimit administrativ, u konstatua se sipas parashikimit të pikave 13 dhe 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, shtetasi A. Xh. A, është person i lidhur me subjektin e rivlerësimit, pasi: (i) është pjesë përbërëse e familjes, sipas certifikatës familjare me nr. \*\*\*, të lëshuar në datën 24.01.2017, nga Zyra e Gjendjes Civile \*\*\*, Vlorë, bashkëngjitur deklaratës “Vetting”; (ii) në të gjitha deklaratat periodike vjetore 2004-2016, subjekti ka deklaruar në rubrikën e të ardhurave, të ardhura në formën e dhurimeve nga vëllai, z. A. A.

Në lidhje me personin e lidhur, ILDKPKI-ja, ka konstatuar<sup>61</sup> mosdeklarimin e të ardhurave të të vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. A. A, në deklaratën “Vetting”, deklaruar ndër vite në shumën totale, rreth 31.000 GBP dhe 550.000 lekë, duke e konsideruar deklaramin e subjektit, deklarim të rremë.

Për të verifikuar deklarimet lidhur me pasuritë dhe të ardhurat e personit të lidhur, zotit A.A, nga ana e Komisionit, u krye një procedurë e mirëfilltë hetimi administrativ, nga e cila rezultoi se:

**4.1.** Nga përgjigjet e zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme<sup>62</sup>, në emër të z. A. A nuk rezulton e regjistruar asnjë pasuri e paluajtshme.

<sup>57</sup> Shihni shkresën \*\*\*, datë 05.04.2018, të “NBG-së”, në dosjen e Komisionit.

<sup>58</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2018, nga “Alpha Bank”, në dosjen e Komisionit.

<sup>59</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\*, datë 04.04.2018, nga “Credins Bank”, në dosjen e Komisionit.

<sup>60</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 04.04.2018, nga “Credins Bank”, në dosjen e Komisionit.

<sup>61</sup> Shihni raportin nr. \*\*\*, datë 13.01.2018, të ILDKPKI-së.

<sup>62</sup> Shihni përgjigjet e zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në dosjen e Komisionit.

**4.2.** DPSHTRR-ja<sup>63</sup>, nuk konfirmon automjet të regjistruar në emër të shtetasit A. A.

**4.3.** Nga verifikimi i dokumenteve bankare në Republikën e Shqipërisë, nuk rezultuan llogari bankare në emër të z. A. A.

**4.4** Instituti i Sigurimeve Shoqërore Vlorë<sup>64</sup>, vërtetoi se shtetasi A. A nuk përfiton pension në Shqipëri.

**4.5.** Shtetasi A. A, është pronar i automjetit tip “Mercedes Benz” C220SE CDI A, me targa angleze \*\*\*, i blerë në datën 10.07.2016, sipas certifikatës së regjistrimit të automjetit të përkthyer në shqip, që mban datën 23.01.2017<sup>65</sup>, **mjet i cili nuk është deklaruar nga A. A dhe as nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting”, në përputhje me detyrimet e shtojcës 2, të ligjit nr. 84/2016.**

**4.6.** Shtetasi A. A, ka pasur të ardhura nga emigracioni, të cilat nuk janë deklaruar prej tij, si dhe as nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting”, në përputhje me detyrimet e shtojcës 2, të ligjit nr. 84/2016. Për të arritur në këtë konkluzion, Komisioni u bazua në deklaratat periodike, të cilat sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, mund të përdoren si provë, për të vërtetuar të ardhurat e deklaruara. Nga verifikimi këtyre deklaratave, u konstatua se:

i) Në deklaratat periodike, nga viti 2004 - 2015, janë deklaruar të ardhura (dhurime) nga vëllai i subjektit, z. A. A, në shumën totale 31.000 GBP dhe 550.000 lekë.

ii) Në deklarinimin për vitin 2016, dorëzuar nga subjekti pranë ILDKPKI-së në datën 24.03.2017, (pas deklaratës “Vetting”) subjekti ka deklaruar të ardhura të vëllait nga emigracioni, në shumën 6.000 GBP, deklarim i cili është në vijimësi pas deklarimeve periodike për të gjitha vitet paraardhëse.

iii) Në deklaratën vetting, nuk janë deklaruar të ardhura nga emigracioni.

**4.7.** Në momentin e plotësimit të deklaratës “Vetting”, vëllai i subjektit, shtetasi A. A, ka pasur në pronësi një autoveturë, si dhe të ardhura nga puna në emigracion, ndërkohë që ka plotësuar vetëm autorizimin sipas të cilit ka deklaruar se nuk disponon pasuri veçmas të regjistruar në emrin e tij. **Edhe pse deklarimi i rremë, në këtë rast është kryer nga ana e shtetasit A. A,** Komisioni vlerëson, se edhe subjekti i rivlerësimit ka përgjegjësi ligjore për shkak të mosplotësimit me vërtetësi të deklaratës “Vetting”, në përputhje me detyrimet e parashikuara në ligjin nr. 84/2016, dhe ia ka kaluar këtë konstatim si barrë prove.

Lidhur me këto konstatime, në parashtrimet e tij, pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka pretenduar se mjeti në emër të të vëllait nuk mund të konsiderohet si i fshehur, pasi ai ka paraqitur dokument pronësie pranë ILDKPKI-së. Në vijim, duke kundërshtuar deklarinimin e rremë, subjekti deklaroi se,<sup>66</sup> “...im vëlla, nuk është e vërtetë që ka bërë deklarim të rremë apo fshehje pasurie sepse nuk përmendet asgjë që është e rreme apo që është e fshehur, ndërsa interpretimi ligjor është alogjik ...të ardhurat e paraqitura nga vëllai im janë deklaruar prej

<sup>63</sup> Shihni shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\*, datë 10.04.2018, nga DPSHTRR-ja, në dosjen e Komisionit.

<sup>64</sup> Sipas vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 28.10.2016, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Sigurime Shoqërore Vlorë.

<sup>65</sup> Shihni dokumentet në Aneksin 4/14, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>66</sup> Shihni shpjegimet e subjektit pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe dokumentacionin bashkëlidhur, dërguar në rrugë elektronike nga subjekti në datë 29.03.2019, dhe me postë të protokolluar nga Komisioni me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 01.04.2019, në dosjen e Komisionit.

*emigracionit dhe jo nga aktiviteti i shtetasit shqiptar jashtë shtetit, im vëlla është shqiptar vetëm brenda kufirit ..., tej atij është shtetas anglez...”*

Lidhur me këto pretendime, Komisioni:

i) e vlerësoi të bazuar pretendimin se nuk është bërë fshehje e pasurisë autoveturë me targa angleze \*\*\*, në pronësi të shtetasit A. A. Për sa kohë që subjekti ka paraqitur dokumente të mjetit pranë ILDKPKI-së, mungon qëllimi për fshehjen e tij. Për këtë arsye, **Komisioni e konsideroi mosdeklarimin e tij, vetëm pasaktësi në deklarimin për “Vetting”, dhe jo si fshehje pasurie.**

ii) e vlerësoi të pabazuar pretendimin se vëllai i subjektit, nuk ka kryer deklaram të rremë, për sa kohë është vërtetuar që, shtetasi A. A, ka pasur në pronësi një autoveturë, si dhe të ardhura nga emigracioni, dhe ka plotësuar vetëm autorizimin, duke deklaruar një fakt të pavërtetë (që nuk disponon pasuri veçmas).

iii) e vlerësoi të pabazuar pretendimin në lidhje me mosdeklarimin e të ardhurave të vëllait nga emigracioni, me arsyetimin se shtojca 2, e ligjit nr. 84/2016, parashikon detyrimin e subjektit të rivlerësimit, për deklarimin e pasurive, burimit të krijimit të tyre dhe të drejtave reale mbi to, për vete, bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe për çdo person të përmendur në certifikatën familjare, pa përjashtuar ata që janë banues në shtete të huaja. Ndërsa, autorizimi, që sipas kësaj shtojce duhet të plotësojnë këta persona, përfshin pasuritë dhe interesat privatë të tyre brenda dhe jashtë vendit. Në kuptim të pikës 3, të nenit D të Kushtetutës, do të konsiderohen pasuri edhe të ardhurat që janë deklaruar. Në këto kushte, **mosdeklarimi i të ardhurave të të vëllait në deklaratën “Vetting” nga ana e subjektit, e bën këtë deklaram të rremë, parashikuar nga germa “ç”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.**

## **GJETJE TË KONSTATUARA NGA VERIFIKIMI I DEKLARATAVE PERIODIKE**

Gjatë hetimit administrativ, pas verifikimit pranë “Alpha Bank”<sup>67</sup>, u konstatua se:

**1.** Subjekti në deklaratën periodike për vitin 2004 nuk ka deklaruar transaksionet bankare dhe burimin financiar të tyre, mbërritur në llogarinë e tij pranë kësaj banke nga:

i) D. C, në datën 21.10.2004, në shumën 2000 euro, dhe në datën 40.01.2006, në shumën 200 euro;

ii) Nationwide Building Society United Kingdom, në datën 19.01.2004, në shumën 2000 GBP, dhe në datën 21.10.2004, në shumën 9000 GBP.

ILDKPKI-ja<sup>68</sup> ka konstatuar se subjekti ka fshehur në deklaratat vjetore të interesave privatë transaksionet bankare dhe burimin financiar të tyre, mbërritur në llogarinë e tij pranë “Alpha Bank”, si më sipër.

Gjatë procesit të rivlerësimit, në përfundim të hetimeve paraprake, pasi janë verifikuar dërgesat si më sipër në vitin 2004 dhe 2006, subjektit i kaloi barra e provës për shkak të mosdeklarimit të tyre në deklaratat periodike për këto vite, duke u konsideruar si fshehje e tyre në këtë deklaram.

<sup>67</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2018, të “Alpha Bank”, në dosjen e Komisionit.

<sup>68</sup> Shihni raportin e ILDKPKI-së nr. \*\*\* prot., datë 13.01.2018, në dosjen e ILDKPKI-së.



Në parashtrimet e tij pas kalimit të barrës së provës, si dhe në seancë dëgjimore,

**1.1** Lidhur me shumat e dërguara nga D. C, subjekti pretendoi se <sup>69</sup> ai është djali i tezes, znj. L. C, i cili jeton në Greqi. Në lidhje me shkakun e kalimit, sqaron se duke qenë se ka kaluar kohë e gjatë, ai mendon se ky shtetas duhet të ketë bërë ndonjë transfertë për nevoja familjare të tij, pretendim i cili u konsiderua i bazuar nga ana e Komisionit, nisur edhe nga fakti se subjekti i ka tërhequr këto shuma brenda vitit 2004 (shumën prej 2000 eurosh) dhe brenda vitit 2006 (shumën prej 200 eurosh)<sup>70</sup>. Veç sa më sipër, subjekti ka vërtetuar që nuk ka pasur për shqyrtim çështje apo materiale që i përkasin këtij shtetasi<sup>71</sup>.

**1.2** Lidhur me derdhjet nga Nationwide Building Society United Kingdom, subjekti ka pretenduar se nuk ka fshehje pasurie dhe se ai nuk ka pasur detyrim t'i deklaronte shumat përkatëse, duke sqaruar se:<sup>72</sup> *“...kreditimet duhet të jenë dërgime nga llogaria e vëllait të tij si klient i tyre, por nuk mund të sqarohë dot për një periudhë që përfshin rreth dy dekada, si mund të kenë qenë dërgesat konkrete...”*

Në kushtet kur vetë subjekti deklaron se këto shuma kanë ardhur në llogarinë e tij nga vëllai i tij, por nuk vërtetoi që ato nuk janë përdorur prej tij, Komisioni vlerëson se subjekti duhet t'i deklaronte këto shuma në deklaratën periodike për vitin 2004, sipas parashikimit të nenit 4, të ligjit nr. 9049, të datës 10.04.2003, i cili përcakton detyrimin e deklaramit të të ardhurave ligjore dhe burimit të tyre. Duke qenë se për këtë vit, subjekti ka deklaruar vetëm shumën prej 550.000 lekësh (rreth 3000 GBP), mosdeklarimi i të ardhurave nga vëllai në emigracion, për diferencën prej 8000 GBP, e bën deklaramin periodik për vitin 2004 të pasaktë. Ndërkohë, subjekti ka fshehur në deklaratën periodike për këtë vit, të ardhurën në shumën prej 8000 GBP, si dhurim prej vëllait.

**2.** “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. \*\*\*, datë 10.04.2018, konfirmon disa depozita/llogari të padeklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Edison Ademi, në deklaratat periodike dhe deklaratën “Vetting”, të cilat ILDKPKI-ja i ka konsideruar si fshehje të gjendjeve në llogari/depozita.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, u çmua se mosdeklarimi ndër vite i disa depozitave/llogarive bankare në shuma të vogla nga ana e subjektit të rivlerësimit, nuk është bërë me qëllim fshehjen e tyre (përderisa ato janë lehtësisht të verifikueshme), dhe si rrjedhim, të mos merret në konsideratë në procesin e vendimmarrjes.

**3.** Në deklaramin periodik për vitin 2007 është deklaruar mjeti tip “OPEL VECTRA”, blerë në këtë vit sipas kontratës me nr. \*\*\*, në çmimin 250.000 lekë. Nga sqarimet e subjektit<sup>73</sup>, rezulton se çmimi i blerjes së mjetit tip “OPEL VECTRA” në vitin 2007 është 1500 euro + zhdoganimi 155.000 lekë.

<sup>69</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit nr.3 dërguar nga subjekti në datën 10.02.2019 dhe dokumentacionin bashkëlidhur, në dosjen e Komisionit.

<sup>70</sup> Vërtetuar me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 25.10.2018, të “Alpha Bank”, në dosjen e Komisionit.

<sup>71</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\*prot., datë 08.02.2019, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë; shkresë me nr. \*\*\*prot., datë 06.02.2019, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; shkresën nr. \*\*\*, datë 08.02.2019, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në dokumentacionin bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3 në dosjen e Komisionit.

<sup>72</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 3 dërguar nga subjekti në datën 10.02.2019 dhe dokumentacionin bashkëlidhur, në dosjen e Komisionit.

<sup>73</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit të dytë dërguar nga subjekti, në datën 24.10.2018, në dosjen e Komisionit.

Gjatë analizës financiare, në përfundim të hetimeve paraprahe, për vitin 2007 është konstatuar se subjekti nuk ka pasur mundësi për blerjen e këtij mjeti, pasi ka rezultuar me një diferencë të pajustificuar në shumën prej 241.321 lekësh.

Pas kalimit të barrës së provës subjekti ka kundërshtuar analizën financiare për këtë vit. Pasi u analizuan pretendimet e tij, u bë rishikimi i kësaj analize (arsyetuar si më poshtë) dhe në përfundim të procesit të rivlerësimit u vërtetua se subjekti ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për blerjen e këtij mjeti.

4. Në deklarinimin periodik për vitin 2014 nuk është deklaruar mjete tip “Volkswagen Golf”, me targa \*\*\*, blerë nga shitësi B. Sh. R<sup>74</sup>, në shumën 1000 euro, mjet i cili nuk rezulton të jetë shitur dhe as të jetë deklaruar si i shitur në vitet në vijim. Për këtë arsye, vlera e blerjes së këtij mjete ishte përfshirë si shpenzim gjatë analizës financiare të kryer gjatë hetimeve paraprahe.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi se gabimisht kjo shumë është përfshirë si shpenzim në analizën financiare, duke argumentuar se ai nuk e ka fituar pronësinë e mjedit, dhe se blerja e tij në vitin 2014 është anuluar me vullnet të palëve.

Nga informacioni i marrë nga DPSHTRR-ja<sup>75</sup>, si dhe shpjegimet e subjektit<sup>76</sup>, rezultoi se automjeti me targë \*\*\* (aktualisht në pronësi të shtetasit A. Rr. A), i është blerë shitësit B. Sh. R, sipas kontratës për shitje automjeti nr. \*\*\*, datë 13.06.2014, në shumën 1.000 euro. Pra, ky mjet nuk është regjistruar nga ana e subjektit pranë DPSHTRR-së, fakt që tregon se, kontrata e shitjes së tij me shitësin B. Sh. R është anuluar prej palëve, sipas pretendimit të subjektit. Për këtë arsye, subjekti nuk e ka deklaruar këtë mjet në deklaratën periodike për vitin 2014. Gjatë rishikimit të analizës financiare, shuma e blerjes prej 1000 eurosh, nuk është përfshirë si shpenzim për këtë vit, gjë që ka çuar në përmirësimin e situatës financiare për vitin 2014.

5. Në lidhje me vendbanimet, në përgjigjet e pyetësorit të parë drejtuar subjektit, në datën 03.04.2018, subjekti ka dhënë sqarime të hollësishme lidhur me vendbanimet gjatë gjithë periudhës së punësimit të tij, si vijojnë:

- Gjatë kohës (periudhës) që ka punuar në Pogradec (prill – gusht 2015) ka banuar në një hyrje në një pallat të ri, e cila i përket të njohurve, në ruajtje e mirëmbajtje, pa pagesë qiraje.
- Gjatë kohës (periudhës) që ka punuar në Fier, (shtator 2015 – shkurt 2016) shkonte pothuajse çdo ditë në Vlorë ose kur i nevojitej, kishte shumë të afërm ku mund të qëndronte.
- Prej kohës që ka ardhur në Sarandë (shkurt 2016) e deri sot, jeton në një banesë 1+1, në fillim të rrugës 5, pallati i ri i firmës “\*\*\*”, që i përket shtetasit Z. M, i afërmi i tij emigrant nga Vlora. Banesa është në ruajtje e mirëmbajtje, pa pagesë qiraje. Kjo banesë është deklaruar prej tij në deklarinimin periodik për vitin 2016.

Është pyetur subjekti në lidhje me huapërdorjet e banesave si më sipër, ku ka dhënë shpjegime për secilën prej tyre<sup>77</sup>, duke deklaruar se: “...nuk ka pasur kontrata për përdorimin e këtyre banesave pasi nuk kanë qenë shtëpi për biznes dhe nuk mund të dihej asnjëherë koha e qëndrimit atje. Me pronarët ka pasur raporte miqësore dhe shoqërore, pa interes reciprok...”

<sup>74</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. prot. extra, datë 16.10.2018, dhe dokumentet shoqëruese, dërguar nga noteri E. A në dosjen e Komisionit.

<sup>75</sup> Shihni shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\*prot., datë 18.1.2018, nga DPSHTRR-ja në dosjen e Komisionit.

<sup>76</sup> Shihni shpjegimet e subjektit pas dërgimit të rezultateve të hetimit, dhe dokumentacionin bashkëlidhur, dërguar në rrugë elektronike nga subjekti, më datë 29.03.2019, dhe me postë të protokolluar nga Komisioni me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 01.04.2019, në dosjen e Komisionit.

<sup>77</sup> Shihni përgjigjet e subjektit dërguar me e-mail, në datën 24.10.2018, në dosjen e Komisionit.

Gjithashtu, subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresore<sup>78</sup>, me të cilat vërtetoi pretendimet e tij, si dhe faktin se me asnjërin prej pronarëve të pasurive të përdorura nuk ka pasur çështje në shqyrtim dhe, si rrjedhim, nuk është në situatë konflikti interesi.

Përveç sa më sipër, nga informacioni i vënë në dispozicion nga ZVRPP-të në rrethe, apo dhe nga burime të tjera, nuk ka pasur të dhëna që subjekti apo personat e lidhur të kenë në pronësi pasuri të tjera, të ndryshme nga ato të deklaruara.

#### 6. Lidhur me të ardhura të përfituara nga vëllai i subjektit, z. A. A, në emigracion:

Gjatë hetimit administrativ, u konstatua se subjekti ka deklaruar në deklaratat periodike për vitet 2004 - 2016, të ardhura të përfituara nga vëllai i tij, shtetasi A. A, në Mbretërinë e Bashkuar, në shumën prej prej 31.000 GBP dhe 550.000 lekë. Me qëllim verifikimin, nëse këto të ardhura janë nga burime të ligjshme, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit D, të Kushtetutës, subjektit të rivlerësimit, i është kërkuar informacion dhe dokumente shkresore.

Bazuar në dokumentet që subjekti ka vënë në dispozicion pranë ILDKPKI-së<sup>79</sup>, si dhe ato të vëna në dispozicion pranë Komisionit gjatë procesit të rivlerësimit<sup>80</sup>, në lidhje me të ardhura të shtetasit A. A në Mbretërinë e Bashkuar, gjatë procesit të rivlerësimit u administruan:

i) listëpagesa nga sistemi kompjuterik, për periudhën e punësimit pranë “\*\*\*\*” (\*\*\*) Ltd, nga data 01.07.2016 – 30.12.2016, të shtetasit A. A, nga të cilat rezulton se janë paguar sigurimet shoqërore dhe tatimet për të ardhurat në total në shumën prej 16.600 eurosh. Gjithashtu, për këtë periudhë, subjekti ka paraqitur *statement* për veprimet e kryera në llogari page;

ii) vërtetim punësimi nga shoqëria “\*\*\*\*”<sup>81</sup>, me të cilin konfirmohen raportet e punës së vëllait të subjektit, z. A. A, për periudhën dhjetor 2002 – shtator 2011, pranë kësaj shoqërie. Sipas dokumentit, në momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, (pra, në shtator të vitit 2011) ai ka përfituar një të ardhur vjetore prej 19.396 GBP, për të cilën nuk është vërtetuar pagimi i detyrimeve tatimore.

Për sa më sipër, u konstatua se **subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument që të vërtetojë të ardhura ligjore të shtetasit A. A në Mbretërinë e Bashkuar përgjatë viteve 2004 deri në vitin 2015, për të cilat të jenë paguar detyrimet tatimore ose sigurimet shoqërore**. Për këto arsye, të ardhurat e pretenduara si dhuratë nga vëllai për këto vite, në shumën prej 25.000 GBP dhe 550.000 leke, nuk janë marrë në konsideratë gjatë analizës financiare për periudhën e vlerësimit, 2003 - 2015. Ndërkohë, të ardhurat e deklaruara për vitin 2016, janë marrë në konsideratë, sipas deklaramit periodik për këtë vit, në shumën prej 6000 GBP, për shkak se subjekti vërtetoi me dokumentacion të rregullt ligjor legalizuar me vulën *Apostile*<sup>82</sup> burimin nga të ardhura të ligjshme të të vëllait të tij.

<sup>78</sup> Shihni dokumentet bashkëngjitur me përgjigjet e datës 24.10.2018, në dosjen e Komisionit.

<sup>79</sup> Shihni Aneksin 4/14 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>80</sup> Vërtetim punësimi lëshuar nga “\*\*\*\*” për periudhën dhjetor 2002 – shtator 2011; listëpagesat për periudhën e punësimit pranë “\*\*\*\*” (\*\*\*) Ltd., nga data 01.07.2016 – 30.12.2016; *statement*-in e veprimeve të kryera në llogarinë e pagës së z. A. A për periudhën 22.02.2016 – 16.04.2016; përgjigjet e pyetjeve shtesë të pyetësorit nr. 3, dërguar nga subjekti në datë 16.02.2019, në dosjen e Komisionit.

<sup>81</sup> Vërtetim punësimi lëshuar nga “\*\*\*\*” për periudhën dhjetor 2002 – shtator 2011.

<sup>82</sup> Shihni dokumentacionin e dërguar në parashtrimet e protokolluara me nr. \*\*\* prot., datë 01.04.2019, paraqitur si fotokopje, origjinalet e të cilave u paraqitën ditën e seancës dëgjimore.

Gjithashtu, gjatë procesit të rivlerësimit i është kërkuar subjektit të vëre në dispozicion dokumentacion zyrtar nga bankat e çdo niveli në Mbretërinë e Bashkuar, për të vërtetuar llogari bankare në emër të vëllait të subjektit, A. A, me gjendjet përkatëse. Në lidhje me këtë kërkesë, subjekti ka sqaruar<sup>83</sup> se informacionet e rezervuara në vendet e Evropës nuk disponohen lehtë, duke vënë në dispozicion printime nga dy banka “Barclays” dhe “Nationwide Building Society”, në të cilat vëllai i tij ka qenë klient, si dhe një dokument të quajtur raportim i shkurtër bankar nga banka “Nationwide” i datës 16 prill 2016, ku përfshihen veprimet të kryera në këtë bankë, nga data 22 shkurt 2016 -16 prill 2016, me kreditime dhe debitime në vlera të pakonsiderueshme. Nga informacionet si më sipër, **lëvizjet në llogari nga ana e shtetasit A. A, nuk vërtetojnë të ardhura të ligjshme të tij, për të cilat të jenë paguar detyrimet tatimore**, si rrjedhim nuk janë marrë në konsideratë.

Lidhur me konstatimet si më sipër, subjektit i kaloi barra e provës, i cili, si në parashtrimet e tij<sup>84</sup>, ashtu dhe gjatë seancës dëgjimore, nuk paraqiti asnjë provë të re për të vërtetuar të kundërtën.

Pika 3, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës; pika 4, e nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 dhe pika 21 e udhëzimit të ILDKPKI-së nr. 4095, datë 10.10.2016, kërkojnë që për të ardhurat e deklaruara, subjektet e rivlerësimit, personat e lidhur, ose persona të tjerë të lidhur me ta, kur këta të fundit janë në kushtet e pikës 4, nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, të provojnë me dokumentacion justifikues ligjshmërinë e krijimit të këtyre të ardhurave dhe pagimin e detyrimeve tatimore për to. Ky detyrim ligjor nuk është përmbushur nga subjekti, për sa i takon të ardhurave të pretenduara, të përfituara nga vëllai gjatë viteve 2004 – 2015 dhe, si rrjedhim, shumat prej 25.000 GBP dhe 550.000 lekësh, nuk janë marrë në konsideratë si e ardhur ligjore gjatë analizës financiare.

Përveç sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se, që të ardhurat të konsiderohen të ligjshme, duhet provuar edhe mënyra se si ato kanë mbërritur te subjekti i rivlerësimit<sup>85</sup>. Subjekti nuk vërtetoi në asnjë rast mënyrën se si shumat e deklaruara si të ardhura nga i vëllai, kanë mbërritur nga shtetasi A. A, tek ai. Edhe për vitin 2004, kur është vërtetuar se në llogari të subjektit ka kaluar shuma prej 11.000 pound, nëpërmjet “Alpha Bank”, nga shoqëria “\*\*\*\*”, për të cilat subjekti deklaroi se janë dërguar nga vëllai i tij, nuk u vërtetua që shumat e dërguara të jenë nga të ardhura të ligjshme.

## ANALIZA FINANCIARE

Analiza financiare për periudhën e rivlerësimit 2003-2016 është bërë mbi bazën e përllogaritjes së të ardhurave, shpenzimeve, vlerave të pasurive të paluajtshme dhe pasurive të luajtshme, për subjektin dhe personat e lidhur me të, me qëllim evidentimin e vlerave të pajustificuara me burime të ligjshme. Në përfundim të hetimit administrativ ka rezultuar se subjekti ka pasur diferencë të pajustificuar me burime të ligjshme në shumën prej 3.082.877 lekësh.

Në analizën financiare nuk janë marrë në konsideratë të ardhura të deklaruara nga subjekti në deklaratat periodike për vitet 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013,

<sup>83</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 3, dhe dokumentacionin bashkëngjitur dërguar nga subjekti, më datë 10.02.2019, në dosjen e Komisionit.

<sup>84</sup> Shihni shpjegimet e subjektit pas dërgimit të rezultateve të hetimit, dhe dokumentacionin bashkëlidhur, dërguar në rrugë elektronike nga subjekti, më datë 29.03.2019 dhe me postë të protokolluar nga Komisioni me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 01.04.2019, në dosjen e Komisionit.

<sup>85</sup> Shihni vendimin e KPA-së nr. 12 datë 17.12.2018.

2014 dhe 2015, të përfituara nga vëllai i subjektit, shtetasi A. A, në total shuma prej 25.000 GBP dhe 550.000 lekë. Ndërkohë që është marrë në konsideratë si e ardhur ligjore shuma prej 6000 GBP, deklaruar për vitin 2016.

Në përfundim të hetimeve paraprake, subjektit i kaloi barra e provës në lidhje me diferencën e pajustificuar në shumën prej 3.082.877 lekësh. Në parashtrimet e tij, subjekti e ka kundërshtuar analizën financiare për të gjithë periudhën e rivlerësimit, duke pretenduar se:

**1. Shpenzimet jetike të tij janë më të ulëta se shpenzimet e llogaritura nga Komisioni:**

Lidhur me këtë pretendim, Komisioni konstatoi se është e vërtetë që shpenzimet e llogaritura nga ILDKPKI-ja ( 7.700.000 lekë), janë të përafërta me shpenzimet e llogaritura nga subjekti i rivlerësimit (7.673.880 lekë). Por, ndërkohë që subjekti ka bërë llogaritjen për 6 persona, ILDKPKI-ja ka bërë llogaritjen për 4 persona. Duke mbajtur po të njëjtin standard si ILDKPKI-ja, por duke llogaritur shpenzimet jetike për 6 (gjashtë) persona, duke përfshirë dhe prindërit e subjektit, rezultoi që pretendimet e subjektit janë të pabazuara.

**2. Llogaritja e shpenzimeve me kartë krediti, ka dublikuar shpenzimet e udhëtimeve pasi me këtë kartë janë paguar dhe shpenzime udhëtimi:**

Lidhur me këtë pretendim, pas analizës së shpenzimeve me kartë krediti, u konstatua vetëm një rast pagese për shpenzim udhëtimi, në vitin 2011, në vlerën 84.086 lekë, i cili u mor në konsideratë gjatë rishikimit të analizës financiare dhe u zbrit nga shpenzimet me kartë krediti të këtij viti, duke përmirësuar gjendjen financiare të subjektit të rivlerësimit.

**3. Shpenzimet e interesave të kredisë nuk janë llogaritur saktë, pasi ato janë më të ulëta, krahasuar me ato të llogaritura nga Komisioni.**

Lidhur me këtë pretendim, ashtu sikurse dhe gjatë procesit të rivlerësimit, ai paraqiti dokumente justifikuese për pagesat e kësteve të kredisë, pas vitit 2009. Ndërsa, për periudhën para vitit 2009, subjekti ka deklaruar<sup>86</sup> se: *“...bazuar në dokumentacionin në dispozicion, në lidhje me kredinë hipotekore në shumën 30.000 USD për 12 vjet; nga ana e “Alpha Bank” është mundësuar vetëm printimi i llogarisë për periudhën prej mars 2009 e në vazhdim. Në pasqyrat e llogarisë jepen të detajuar pagesat e interesave në monedhën USD për çdo këst tremujor të paguar (pasqyruar në tabelën më poshtë për vitin 2009-2015, deri në shlyerjen e plotë të kredisë). Për periudhën prej fillimit të pagesës së këstit të parë e deri në mars 2009 për të llogaritur interesat e llogaritura i jemi referuar planit të amortizimit të kredisë...”*

Lidhur me këtë pretendim, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: *“Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër, institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor”,* subjekti provoi pamundësinë për të vërtetuar interesat e paguara të kredisë për këtë periudhë, për shkak se “Alpha Bank”, nuk disponon dokumentacion vërtetues për periudhën para muajit mars

---

<sup>86</sup> Shihni shpjegimet mbi analizën financiare 2003 - 2016, sipas hetimit administrativ, pjesa 2, në parashtrimet e datës 29.03.2019.

2009<sup>87</sup>. Në këto kushte, Komisioni mori të mirëqenë llogaritjen e këtyre interesave përpara marsit të vitit 2009,<sup>88</sup> referuar planit të amortizimit të kredisë, sipas pretendimeve të subjektit, dhe për këtë arsye, pas rishikimit të analizës financiare, u bë rillogaritja e vlerës së interesave të kredisë, gjë që përmirësoi situatën financiare të subjektit të rivlerësimit.

4. Të ardhurat *cash* në fund të çdo viti nuk janë përfshirë në llogaritjen përmbledhëse të çdo viti pasardhës.

Lidhur me këtë pretendim, Komisioni çmon se detyrimi ligjor i subjekteve deklaruese për deklarimin e vlerës së likuiditeteve, gjendjes në *cash* etj., në deklaratat periodike vjetore të interesave privatë, është detyrim i përcaktuar shumë qartë që në fillim, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve, dhe të disa nëpunësve publikë”. Për këtë arsye, pretendimi i subjektit që balancat pozitive në fund të çdo viti t’i shtohen gjendjes së likuiditetit të atij viti, nuk mund të merret në konsideratë. Balancat pozitive tregojnë shumën e shpenzimeve përtej shpenzimeve të llogaritura nga Komisioni. Përveç kësaj, subjekti nuk ka deklaruar gjendjet *cash* të pretenduara, në fund të viteve respektivë.

Gjithashtu, në seancën dëgjimore, subjekti kërkoi të pyetet me cilësinë e dëshmitarit, eksperti kontabël i caktuar prej tij, dhe me vendimin nr. 5, datë 05.04.2019, Komisioni vendosi ta refuzojë këtë kërkesë, me arsyetimin se eksperti kontabël i caktuar prej subjektit, z. B. H, ka paraqitur vlerësimin e tij në aktin RAPORT VLERËSIMI KONTABËL, datë 23.03.2019, administruar nga Komisioni, së bashku me parashtrimet e datës 29.03.2019.

Pas shqyrtimit të pretendimeve të subjektit, si më sipër, në përfundim të procesit të rivlerësimit, u bë rishikimi i analizës financiare, nga e cila rezultoi se, shuma e pasurisë dhe shpenzimeve të pajustificuara me burime të ligjshme është 2.473.568 lekë.

### **Metodologjia e përdorur në analizën financiare:**

Gjatë kësaj analize, Komisioni është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga: “Raiffeisen Bank”<sup>89</sup>, “Procredit Bank”<sup>90</sup>, “BKT”<sup>91</sup>, “Intesa Sanpaolo Bank”<sup>92</sup>, “Tirana Bank”<sup>93</sup>, “Credins Bank”<sup>94</sup>, “Alpha Bank”<sup>95</sup>, “NBG”<sup>96</sup> si dhe gjendjet *cash* të deklaruara nga subjekti<sup>97</sup>;

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:

---

<sup>87</sup> Shihni *e-mail-in* e datës 11.01.2019 nga “Alpha Bank”, në dosjen e Komisionit.

<sup>88</sup> Shihni tabelën në f. 5 të shpjegimeve, mbi analizën financiare 2003 - 2016, sipas hetimit administrativ, pjesa 2, në parashtrimet e datës 29.03.2019.

<sup>89</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 10.04.2018, nga “Raiffeisen Bank”.

<sup>90</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 11.04.2018, nga “Procredit Bank”.

<sup>91</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 18.04.2018, nga “BKT”.

<sup>92</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 13.04.2018, nga “Intesa San Paolo Bank”.

<sup>93</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 17.04.2018, nga “Tirana Bank”.

<sup>94</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 04.04.2018, nga “Credins Bank”.

<sup>95</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2018, nga “Alpha Bank”.

<sup>96</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 05.04.2018, nga “NBG”.

<sup>97</sup> Shihni deklaratimet periodike të çdo viti, në dosjen e ILDKPKI-së.

- i) Të ardhurat nga pagat e subjektit në: Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për periudhën 1998 - 2015<sup>98</sup>, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec në vitin 2015<sup>99</sup>, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për periudhën 2015 - 2016<sup>100</sup>, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë gjatë vitit 2016<sup>101</sup>, si dhe të ardhurat për punën pranë Universitetit “Ismail Qemali” në vitin 2004<sup>102</sup>.
- ii) Të ardhurat nga pagat e bashkëshortes së subjektit në: Institutin e Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Vlorë, për periudhën 2005 - 2009<sup>103</sup>, në Zyrën Rajonale të Punësimit Vlorë për pagesë papunësie në vitin 2009<sup>104</sup>, në “ProCredit Bank” për periudhën 2009 - 2011<sup>105</sup>, të ardhura për periudhën 2012 - 2015<sup>106</sup>, në Entin Kombëtar të Banesave për periudhën 2015 - 2016<sup>107</sup>, si dhe të adhurat për raportet e barrëindjes<sup>108</sup>.
- iii) Të ardhurat nga pensioni për babanë e subjektit të rivlerësimit, z. Xh. A<sup>109</sup>.
- iv) Të ardhurat nga pensioni për nënën e subjektit të rivlerësimit, znj. H. A<sup>110</sup>.

c. Shpenzimet, ku përfshihen:

- i) Shpenzimet e jetesës, bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë që njeh anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT<sup>111</sup>.
- ii) Shpenzime udhëtimi për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi *TIMS*. Për përllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si bazë shpenzimet mesatare të udhëtimeve sipas linjave ajrore, duke filluar nga 180 euro për udhëtim, deri në 300 euro për udhëtim për linjat më të gjata. Në rastet kur ka informacion për destinacionet e largëta, shpenzimet e udhëtimit janë llogaritur, duke parë në internet çmimet mesatare të destinacionit përkatës. Ndërsa, për shpenzimet e qëndrimit janë llogaritur 50 euro/ditë shpenzim qëndrimi dhe ushqimi.
- iii) Shpenzime arredimi të deklaruara nga subjekti në pyetësorët e dërguar nga Komisioni.
- iv) Shpenzime interesa dhe principal për shlyerjen e kredisë financiare me “Alpha Bank”<sup>112</sup>, si dhe shpenzime interesa dhe principal për kredinë në “Raiffeisen Bank”<sup>113</sup>.

ç. Në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e shitblerjeve të këtyre pasurive<sup>114</sup>.

## IV.2 VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

<sup>98</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 17.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

<sup>99</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 24.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

<sup>100</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 17.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

<sup>101</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 23.01.2017, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

<sup>102</sup> Vërtetim, datë 26.01.2017, nga Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë.

<sup>103</sup> Vërtetim për bazën e vlerësueshme nr. \*\*\* prot., datë 25.01.2017, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Drejtoria Rajonale Vlorë

<sup>104</sup> Vërtetim datë 24.10.2016 nga Zyra Rajonale e Punësimit Vlorë.

<sup>105</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 14.11.2016, nga Drejtoria Arkivit Qendror.

<sup>106</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 10/04/2018, nga “Raiffeisen Bank”.

<sup>107</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 20.04.2016, nga Enti Kombeetar i Banesave.

<sup>108</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 25.01.2017, dhe vërtetim nr. \*\*\* nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Vlorë.

<sup>109</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 28.10.2016, nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Vlorë.

<sup>110</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 28.10.2016, nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Vlorë.

<sup>111</sup> Shihni vendimin nr. 2 datë 22.06.2018, bashkëngjitur tabela për shpenzimet mujore për konsum, në dosjen e Komisionit.

<sup>112</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2018, nga “Alpha Bank”.

<sup>113</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 10.04.2018, “Raiffeisen Bank”.

<sup>114</sup> Shihni kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme, në dosjen e ILDKPKI-së.

Sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, nga ana e Komisionit, është bërë rivlerësimi profesional për subjektin e rivlerësimit, z. Edison Ademi, bazuar në:

**1. Raportin për analizën e aftësive profesionale kryer nga Prokuroria e Përgjithshme, i cili është bazuar në:**

i) Formularit të vetëdeklarimit, të tre dokumenteve ligjore të përzgjedhur nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjerë që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;

ii) Pesë dosjet penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;

iii) Të dhënat nga 23 prokuroritë pranë Gjykatë s së Rrethit Gjyqësor, Drejtorisë së Përgjimeve të Telekomunikimit dhe marrëdhënieve me Shërbimet Informative dhe Zyra e Informacionit të klasifikuar, Sektori i Protokoll – Arkivit, si dhe burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

**2. Informacionin e marrë në rrugë zyrtare nga:**

i) Dokumentet dhe dosjet e vëna në dispozicion nga Prokuroria e Përgjithshme;

ii) Tre denoncime<sup>115</sup> nga publiku, nga të cilat pas verifikimit, nuk rezultuan të dhëna lidhur me mangësi në aftësitë profesionale të subjektit, apo veprime të njëanshme dhe korruptive të kryera prej tij sipas parashikimit të nenit 53/2, të ligjit nr. 84/2016;

iii) Informacione të marra nga institucionet kompetente, duke përfshirë edhe ato konfidenciale.

**3. Kriteret e parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas parashikimit të: (i) nenit 73, për aftësitë profesionale; (ii) nenit 74, për aftësitë organizative; (iii) nenit 75, për etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale; dhe (iv) nenit 76, për aftësitë profesionale dhe angazhimin profesional.**

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, nga ana e Komisionit, për subjektin e rivlerësimit, z. Edison Ademi, u konstatua sa vijon:

**1. Lidhur me aftësitë profesionale, sipas parashikimit të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “ Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.**

Njohuritë ligjore: Subjekti i rivlerësimit ka aftësi shumë të mira në interpretimin të ligjit, analizën e jurisprudencës dhe arsyetimit ligjor e logjik, duke marrë vendime dhe përpiluar akte të plota dhe të qarta.

Arsyetimi ligjor : Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në pasqyrimin e rrethanave të faktit, analizën e provave dhe ballafaqimin e tyre me bazën ligjore të aplikueshme. Aktet e përpiluara prej tij janë të qarta e të kuptueshme, duke respektuar në përgjithësi rregullat e drejtshkrimit. Niveli i

---

<sup>115</sup> Shihni denoncimin e shtetasit K. D me nr. \*\*\* prot., datë 20.07.2018, protokolluar nga Komisioni; denoncimin e shtetasit E. D, me nr. \*\*\* prot., datë 29.06.2018, protokolluar nga Komisioni; denoncimin e shtetasit E. S, me nr. \*\*\*, datë 08.02.2018, protokolluar nga Komisioni, në dosjen e Komisionit.



arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor, i vlerësuar “shumë mirë”, për tre vitet e fundit.

**2.** Lidhur me aftësitë organizative, sipas parashikimit të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016 “ Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë: Referuar statistikës së ngarkesës (gjithsej 280 çështje të trajtuara), por edhe organizimin e punës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, numrin e prokurorëve, organizimin e punës, ngarkesën në hetimin dhe përfaqësimin në gjykim të çështjeve penale, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit është përballur me një ngarkesë të konsiderueshme pune dhe në përgjithësi ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës duke kryer detyrat e ngarkuara me efikasitet. Vendimet janë marrë përgjithësisht brenda një afati të arsyeshëm, megjithëse është evidentuar në një rast, tejkalimi i afateve<sup>116</sup> të shqyrtimit të çështjes.

Aftësia për të kryer procedurat hetimore: Subjekti i rivlerësimit ka aftësitë e nevojshme për kryerjen e veprimeve hetimore procedurale, si dhe në drejtimin dhe kontrollin mbi hetimet e kryera nga policia gjyqësore për të mbështetur akuzën në çështjet me të pandehur të dërguar për gjykim. Në procedimet penale për të cilat është vendosur pushimi i hetimeve, nga ana e tij, është realizuar kontrolli dhe drejtimi i hetimeve të kryera nga policia gjyqësore, dhe në përfundim është vendosur pushimi i procedimeve penale. Në rastet e vendimmarrjeve mbi mosfillimin e procedimeve penale, rezulton të ketë vlerësuar me korrektësi materialet kallëzuese, duke argumentuar mungesën e elementëve të veprës penale.

Aftësia për të administruar dosjet: Nga vëzhgimi i akteve të dorëzuara nga subjekti dhe pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, ka aftësi për të administruar dosjet.

**3.** Lidhur me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, sipas parashikimit të nenit 75, të ligjit nr. 96/2016, “ Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë hetimit administrativ, kanë rezultuar në disa raste, shkelje të etikës nga ana e subjektit të rivlerësimit, si vijojnë:

**3.1.** Në lidhje me shtetasin F. D, gjatë hetimit administrativ u konstatua se:

**a.** Në datën 28.11.2011, është regjistruar çështja “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve”<sup>117</sup> në ngarkim të shtetasit F. D, e cila i është caktuar për hetim prokurorit D. T. Pas kërkesës së tij për zëvendësim, për shkak të ngarkesës së punës dhe numrit të dosjeve që ka marrë gjatë vitit 2011, në datën 01.12.2011, çështja i kaloi për shqyrtim subjektit të rivlerësimit, prokurorit Edison Ademi.

**b.** Nga informacioni sekret i marrë pranë organeve ligjzbatuese nga ana e trupit gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, u konstatua se nga numri i celularit \*\*\*, i deklaruar prej subjektit në përdorim të tij (në formularin për kontrollin e figurës), është komunikuar me shtetasin F. D, në muajin korrik 2011, me të cilin është lënë takim në një lokal në Vlorë.

<sup>116</sup> Shihni dosjen nr. 3 nga 5 dosjet e hedhura me short në dosjen e vlerësimit profesional nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme.

<sup>117</sup> Shihni vendimin për dërgimin e çështjes në gjykatë të datës 30.12.2011, të çështjes në ngarkim të të pandehurit F. D, të prokurorit Edison Ademi, në dosjen e Komisionit.

c. I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit, nëse e njeh shtetasin F. D, dhe marrëdhëniet me të, subjekti është shprehur<sup>118</sup> se: “... nuk njoh ndonjë person me këtë emër dhe nuk kam asnjë lloj kontakti me të. Realisht nuk po kujtoj person me këtë emër...”

Në përfundim të hetimeve paraprake, subjektit i ka kaluar barra e provës në lidhje me faktet:

i) duket se subjekti, i cili ka pasur njohje me shtetasin F.D, ka marrë në shqyrtim një çështje penale në ngarkim të tij, duke qenë në kushtet e detyrimit për të hequr dorë nga çështja sipas parashikimit të neneve 17 e 26 të Kodit të Procedurës Penale, gjë të cilën nuk e ka bërë;

ii) duket se subjekti nuk ka deklaruar fakte të vërteta lidhur me njohjen me shtetasin F. D.

Pas kalimit të barrës së provës, si dhe në seancën dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nuk është në situatën e konfliktit të interesit dhe ka paraqitur parashtrime, si dhe dokumente shkresore për këtë<sup>119</sup>, ashtu sikurse ka parashtruar sqarime në lidhje me njohjen me shtetasin F. D.

Konkretisht, ai deklaroi se: “... nuk e njoh, s’kam si ta mbaj mend (s’ka arsye) emrin F. D. Nuk e kam as të mundur as të detyrueshme ligjërisht dhe etikisht të mbaj mend gjithë personat që kam pasur në ndjekje penale, pasi kam pasur të bëj me mijëra persona në 21 vite punë. Në këtë kontekst është mëse normale të mos mbaj mend një çështje të para 8 viteve. E kam njohur si E., madje dhe kur kam marrë dosjen të jeni të sigurt që nuk e dija se e kish emrin F., ... E kisha harruar në fakt që ekzistonte dhe “E. K apo E. D” sepse nuk mbaj as mend kur e kam parë për herë të fundit dhe as vitin kur mund të kem komunikuar. ... E kam njohur se është rritur në një lagje me mua si shumë të tjerë, në lagjen e famshme të vitit 1997 me emrin “\*\*\*” ose “\*\*\*” zyrtarisht...”

Nga deklaratimet e tij, vërtetohet se subjekti e ka njohur më parë këtë person, por me emrin “E. D” ose “\*\*\*”. Pretendimi i tij se: “... nëse e kishit këtë informacion, kishit detyrimin etik që para se të konkludoni të më pyesnit dhe nëse njoh personin me emrin “E. D” ose dhe “\*\*\*”, sepse me emrin F. të jeni të sigurt që dhe pas ca kohësh do ta harroj prapë...” nuk qëndron, pasi Komisioni, nuk mund të kishte dijeni që, shtetasit F. D, i thërrisnin “\*\*\*”, “\*\*\*” ose “\*\*\*”.

Është e vërtetë se subjekti mund ta ketë njohur shtetasin F. D me këto emra, por në momentin e marrjes në shqyrtim të një çështjeje penale në ngarkim të tij, në muajin korrik të vitit 2011, ai është vënë në dijeni të faktit që “\*\*\*”, “\*\*\*” ose “\*\*\*” që ai njihte, ka qenë i njëjtë me personin F. D, ashtu sikurse vetë deklaroi: “... e kam njohur si \*\*\*, madje dhe kur kam marrë dosjen të jeni të sigurt që nuk e dija se e kish emrin \*\*\* ...”

Për sa më sipër, Komisioni vlerësoi se subjekti nuk vërtetoi të kundërtën e konstatimeve, pas kalimit të barrës së provës, dhe krijoi bindjen se, në momentin e përgjigjes së pyetjes gjatë procesit të rivlerësimit (në pyetësorin e datës 06.03.2019), subjekti e njihte shtetasin F. D, por ka deklaruar në mënyrë të prerë që nuk e njihte, pra, një fakt që vjen në kundërshtim me realitetin.

<sup>118</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit të datës 06.03.2019, dërguar nga subjekti me shkresën me nr. \*\*\* prot., E.A, datë 07.03.2019, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 11.03.2019, në dosjen e Komisionit.

<sup>119</sup> Shihni shpjegimet e subjektit pas dërgimit të rezultateve të hetimit, dhe dokumentacionin bashkëlidhur, dërguar në rrugë elektronike nga subjekti, më datë 29.03.2019, dhe me postë të protokolluar nga Komisioni me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 01.04.2019, në dosjen e Komisionit.

Lidhur me konfliktin e interesit në shqyrtimin e çështjes penale në ngarkim të shtetasit F. D, subjekti e kundërshtoi duke pretenduar se, nuk ka pasur ligjërisht asnjë konflikt interesi, por ka zbatuar ligjin, duke deklaruar se<sup>120</sup>: “...nuk kam qenë unë autoriteti që shpërndaja apo zgjidhja dosjet, nuk i kam bërë asnjëherë bisht çdo lloj dosjeje dhe punës ...jemi shtet i vogël dhe qyteti gjithashtu, ndaj nuk është çudi dhe është tepër normale që të shqyrtosh raste të personave që njeh. ... njohja, por shpesh dhe më tepër, është tregues se zbaton ligjin pa dallim. ... shkaqe ligjore për refuzimin e trajtimit të çështjes nuk kisha sepse nuk ndaj me të interesa, përfitime, lidhje kaq të afërta sa të më ndikojnë punën, etj. Në funksionin tim dorëheqjet nuk janë normalitet, janë as sa gishtat e dorës në tërë këto vite, shpesh dhe kur ka pasur rrisqe konkrete në drejtimin tim apo të familjes... të bësh detyrën nuk ka rëndësi nëse e njeh personin ... nuk është në karakterin tim të tërhiqem kollaj... konflikti i interesit nis nga interesi dhe jo nga hamendësitë ...”

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni vlerësoi se këto pretendime, nuk e përjashtojnë subjektin nga detyrimi për të paraqitur dorëheqjen nga shqyrtimi i çështjes në ngarkim të shtetasit F. D, për shkak të rrethanave të njohjes, të cilat mund të ndikonin në hetimin e çështjes me objektivitet. Pasi subjekti të përmbushte detyrimin e tij, sipas parashikimit të neneve 17 e 26 të Kodit të Procedurës Penale, i takonte drejtuesit të prokurorisë për të vlerësuar nëse subjekti duhet të vijonte me shqyrtimin e çështjes.

**Për sa më sipër, Komisioni krijoi bindjen se, mos’heqja dorë nga shqyrtimi i çështjes që i përkiste shtetasit F. D, si dhe qëndrimi mohues për njohjen me këtë shtetas, tregojnë veprime e mosveprime të subjektit të rivlerësimit, që vijnë në kundërshtim me etikën e një prokurori.**

Në lidhje me informacionin konfidencial, sipas të cilit subjekti ka pasur një kontakt telefonik me shtetasin F. D, Komisioni nënvizon se ky informacion, si dhe dokumentacioni që lidhet me të, nuk mund të përdoren në aktet publike, apo të vihen në dispozicion të subjektit të rivlerësimit, sipas legjislacionit për administrimin e informacionit të klasifikuar sekret shtetëror. Referuar jurisprudencës së Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila në vendimin e datës 19.09.2017, është shprehur në çështjen me nr. \*\*\*, - Ragner c/ Republikës Çeke<sup>121</sup>, këto informacione konfidenciale, janë përdorur nga ana e trupit gjykues gjatë procesit të rivlerësimit.

### 3.2 Në lidhje me shtetasin E. M, është konstatuar se:

<sup>120</sup> Shihni shpjegimet e subjektit pas dërgimit të rezultateve të hetimit, dhe dokumentacionin bashkëlidhur, dërguar në rrugë elektronike nga subjekti, më datë 29.03.2019, dhe me postë të protokolluar nga Komisioni me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 01.04.2019, në dosjen e Komisionit.

<sup>121</sup> “...gjykatat kanë qasje të pakufizuar në të gjitha dokumentet e klasifikuara në të cilat Autoriteti është bazuar vetë në mënyrë që të justifikojë vendimin e tij. Ato kanë edhe autoritetin për të kryer një shqyrtim të hollësishëm të arsyeve të mbështetura nga Autoriteti për moszbulimin e dokumenteve të klasifikuara. Ata mund të vlerësojnë arsyet e dhëna për moszbulimin e dokumenteve të klasifikuara dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të atyre që konsiderojnë se nuk e garantojnë atë klasifikim ...”, “.....e drejta për zbulimin e provave përkatëse nuk është një e drejtë absolute. Në çështjen penale ka gjetur se mund të ketë interesa konkurruese, siç është siguria kombëtare ose nevoja për të mbrojtur dëshmitarët në rrezik të hakmarrjes ose të mbajë sekret metodat e policisë për hetimin e krimin, të cilat duhet të vlerësohen kundrejt të drejtave të palës në gjykim...”, “.... Në rastet kur provat nuk i janë vënë në dispozicion kërkuesit për arsye të interesit publik, gjykata duhet të shqyrtojë procedurën e vendimmarrjes për të siguruar që, për aq sa është e mundur, t’i përmbahet kërkesave për të siguruar parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve dhe të ofrojë garanci të përshtatshme për të mbrojtur interesat e personit në fjalë...” 10 “... Dhoma konkludoi se arsyet për vendimin e mospasjes akses (moszbulimit) të dokumentit në fjalë nga ana e kërkuesit ishin bazuar në interesa të sigurisë kombëtare, sepse sipas autoriteteve, zbulimi mund të kishte pasur efektin e zbulimit të metodave të punës të shërbimit të inteligjencës dhe burimet e tij të informacionit ose mund të çonin në përpjekjet e kërkuesit për të ndikuar mbi dëshmitarët e mundshëm. Sipas Dhomës, procedura e vendimmarrjes plotësonte “aq sa ishte e mundur” kërkesat e procesit të drejtë, dhe me ballafaqim, dhe barazisë së armëve në proces dhe përfshinte mbrojtje të përshtatshme të të drejtave dhe interesave të aplikantit, dhe kështu nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 i Konventës ....”

i) Nga të dhënat e sistemit *TIMS* rezultoi se, më datë 30.03.2014, ora 11:47, subjekti Edison Ademi, ka kaluar kufirin shqiptar nga pika kufitare e Morinës, me automjetin me targa \*\*\*, në pronësi të shtetasit E. M.<sup>122</sup>, dhe ka hyrë në territorin shqiptar po nga kjo pikë kalimi dhe me të njëjtin automjet, në datën 01.04.2014, në orën 02:39.

ii) Po në këto data dhe orët përkatëse është konstatuar se ka kaluar kufirin me po të njëjtin mjet në pronësi të tij, shtetasi E. M.

iii) Nga informacioni i vënë në dispozicion nga institucionet kompetente, rezulton se shtetasi E. M është proceduar penalisht për disa vepra penale në vitin 2016.

iv) Është pyetur subjekti i rivlerësimit, vetëm për faktin nëse njihet me shtetasin E. M, dhe nëse po, cilat janë marrëdhëniet me këtë shtetas, dhe subjekti deklaroi se:<sup>123</sup> “... *Njoh personin me këtë emër “\*\*\*” banues në Fier...*” Në shpjegimet e tij, ai lë të kuptohet se nuk është i sigurt nëse është personi për të cilin i kërkohet informacion, nëse është ai që ai njeh, dhe në vijim shprehet se: “... nuk kam dhe nuk kam pasur asnjë lloj marrëdhënie interesi, pune, biznesi, ortakëri etj., me këtë person dhe as nuk e kujtoj kur ka qenë kontakti i fundit, ... këto lloj kontaktesh i mbeten vetëm rastësisë”.

Nga provat dhe faktet si më sipër, subjektit i ka kaluar barra e provës për konstatimin: Duket se subjekti ka deklaruar fakte të pavërteta në lidhje me njohjen me shtetasin E. M.

Pas kalimit të barrës së provës, por edhe në seancë dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka dhënë të njëjtat shpjegime <sup>124</sup> me ato të dhëna gjatë procesit të rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit të datës 06.03.2019, duke deklaruar se: “...*Kam shpjeguar më parë, njoh person me këtë emër “\*\*\*” banues në Fier...*”. Pasi sqaron disa lidhje familjare të babait të tij me familjarë të një personi me emrin \*\*\*, deklaroi se: “... gjithnjë nëse bëhet fjalë për këtë person që njoh unë, nuk kam pasur dijeni për hollësi të jetës së tij private apo për probleme të tij me ligjin, sipas dijenisë time është kthyer nga emigracioni dhe është marrë me biznes, plus që nuk i bie të takoj shpesh të njohurit dhe të afërmit e mi nga Fieri e Patosi, pasi unë prej vitesh nuk arrij të çmalle me familjarët e mi apo dhe me të afërmit që i kam në Vlorë, afër prindërve të mi. ...marrëdhënia ime e vetme janë këto njohje që përmend. Nuk kam dhe nuk kam pasur asnjë lloj marrëdhënie interesi, pune, biznesi, ortakëri etj., me këtë person dhe as nuk e kujtoj kur ka qenë kontakti i fundit, për më tepër unë e kam kohën e kufizuar që të lëviz e takoj njerëz dhe këto lloj kontaktesh i mbeten vetëm rastësisë.”

Ndërkohë , duke pranuar njohjen me këtë shtetas, shton se: “... lëvizja për në Kosovë, ka qenë, me sa kujtojmë, për interesin tim që të prenotoja llixhat e mamasë (kuptohet deri sa kam lënë familjen në ditën e ditëlindjes time). Ka qenë e vetmja lëvizje dhe realisht as nuk e kujtoja. Llixhat në Kosovë e konfirmojnë këtë...” Në vijim, subjekti deklaroi se: “...*deri në atë moment ka qenë qytetar i lirë dhe pa problem...*”, duke sqaruar se nuk mund të mbajë përgjegjësi për sjelljen e personave në kohë, dhe se nuk ka ligjërisht asnjë lidhje tjetër me këtë person.

<sup>122</sup> Shihni kontratë shitblerje mjeti nr. \*\*\*, datë 11.08.2016, dhe kontratë shitblerje mjeti nr. \*\*\* kol., datë 24.09.2013, në dokumentet bashkëlidhur shkresës nr. \*\*\* prot., datë 25.02.2019 ,të DPSHTRR-së në dosjen e Komisionit.

<sup>123</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit të datës 06.03.2019, me nr. \*\*\* prot., E.A, datë 07.03.2019, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 11.03.2019, në dosjen e Komisionit.

<sup>124</sup> Shihni shpjegimet e subjektit pas dërgimit të rezultateve të hetimit, dhe dokumentacionin bashkëlidhur, dërguar në rrugë elektronike nga subjekti, më datë 29.03.2019, dhe me postë të protokolluar nga Komisioni me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 01.04.2019, në dosjen e Komisionit.

Siç shihet qartë, nga të gjitha deklaratimet, subjekti ka dhënë shpjegime kontradiktore dhe të pavërteta në lidhje me njohjen me shtetasin E. A. M. Në deklaratimet e tij në përgjigjet e pyetësorit të datës 06.03.2019, subjekti fillimisht, lë të kuptohet se nuk e njeh këtë shtetas, dhe nëse ky shtetas është ai \*\*\* që ai njeh, marrëdhëniet me të kanë qenë shumë të largëta. Ndërkohë ,deklaron se ka qenë në Kosovë me këtë shtetas, ditën e ditëlindjes së tij, për interesin e tij, pasi kanë shkuar për t'u interesuar për të prenotuar llixha në emër të nënës së tij, fakte që bien në kundërshtim me deklaratimin se nuk kam pasur asnjë lloj marrëdhënie interesi, dhe hedhin poshtë pretendimin se subjekti nuk e kujtonte udhëtimin për në Kosovë, por, përkundrazi, tregojnë se ky udhëtim, ka qenë pikërisht për shkak të njohjes që ata kanë pasur me njëri-tjetrin. **Edhe në këtë rast, Komisioni vlerëson se qëndrimet kontradiktore të subjektit, në lidhje me njohjen me shtetasin E. M, nuk janë në etikën e një prokurori.**

Për sa i përket pretendimit të subjektit se ai nuk duhet të mbajë përgjegjësi për veprime të këtij shtetasi, i cili mund të ketë devijuar nga rruga ligjore në periudhën pasi ata kanë udhëtuar së bashku, Komisioni thekson se, ashtu sikurse u nënvizua edhe në seancën dëgjimore, gjatë procesit të rivlerësimit për z. Edison Ademi, nuk janë marrë në shqyrtim kontaktet e tij me shtetasin E. M, si person i përfshirë në procedime penale, pasi subjekti nuk është vlerësuar për kriterin e figurës.

Kërkimi për procedime penale të mundshme të shtetasit E. M pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda, është bërë nga ana e Komisionit, për nevoja të hetimit administrativ. Sipas pikës 4, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, *“Komisioni dhe Kolegji i Apelimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indice në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes”*. Sipas pikës 1, të nenit 50, të këtij ligji: *“Komisioni, Kolegji i Apelimit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë, bashkëpunojnë me organet shtetërore, personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, për të verifikuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklaratimeve të bëra nga subjektet e rivlerësimit”*. Sipas kësaj dispozite ligjore, dhe parashikimeve të pikave të tjera të saj, Komisioni ka të drejtën të ushtrojë akses të plotë në të gjitha të dhënat, me qëllim rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Legjitimuar nga këto dispozita ligjore, pasi u verifikua në sistemin TIMS, që subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar në të njëjtat ditë, në të njëjtat orë dhe në të njëjtin mjet me shtetasin E. M, Komisioni ka kërkuar të dhëna në lidhje me këtë shtetas dhe pas informacionit të marrë, është parë e arsyeshme të pyetet subjekti, vetëm në lidhje me njohjen dhe marrëdhënien me këtë shtetas, dhe vetëm me qëllim verifikimin e përputhjes së fakteve, me deklaratimet e subjektit. **Deklarimet e tij në lidhje me njohjen me këtë shtetas, janë marrë në konsideratë në vlerësimin e etikës së tij si prokuror, dhe jo në vlerësimin e figurës.**

**3.3 Për shkak të mosheqjes dorë nga marrëdhënia e qiramarrjes për një afat prej 99 vitesh** me Komunën Qendër Vlorë, pas ndryshimeve të vitit 2014, të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, trajtuar si më sipër në këtë vendim, **subjekti ka cenuar etikën e një prokurori**, si pjesë e sistemi të drejtësisë, veprimet e të cilit, më shumë se kushdo tjetër funksionar i shtetit, duhet të jenë në përputhje me ligjin dhe frymën e tij.

**4. Lidhur me aftësitë personale dhe angazhimin profesional**

Aftësia e komunikimit: Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, nuk rezultojnë të dhëna të caktuara që flasin për mënyrën e komunikimit ndërpersonal të subjektit me pjesëmarrësit në proces.

Aftësia për të bashkëpunuar: Ka treguar aftësi të lartë drejtuese e kontrolluese, duke bërë një organizim shumë të mirë të punës në prokurori. Ka shfaqur aftësi të veçanta dhe këmbëngulje në organizimin me efektivitet të burimeve njerëzore të prokurorisë që drejton. Si drejtues prokurorie ka shfaqur aftësi për sa i përket ndërtimit dhe ruajtjes së marrëdhënieve me të gjitha institucionet ligjzbatuese me të cilat ka ndërvepruar.

Gatishmëria për t'u angazhuar: Ka marrë pjesë në aktivitete profesionale, si për ngritjen e nivelit profesional, ashtu edhe në shkëmbimin e eksperiencave apo përfaqësimin e institucionit brenda dhe jashtë vendit dhe, për këtë, është pajisur me certifikatat përkatëse.

## **V. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES**

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues çmon se:

1. Lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit: (i) ka kryer deklaramë të pasakta e të pamjaftueshme në deklaratën "Vetting"; (ii) ka deklarim të rremë në deklaratën "Vetting" për shkak të mosdeklarimit të të ardhurave të vëllait z. AA në emigracion; (iii) nuk ka vërtetuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të vëllait në emigracion për vitet 2004 - 2015, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës; (iii) gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit, ka një diferencë të pajustificuar me të ardhura të ligjshme në shumën prej 2.473.568 lekësh.
2. Lidhur me kriterin e aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit, me veprimet ose mosveprimet e tij, ka cenuar në disa raste etikën e një prokurori.
3. Në vlerësimin tërësor të çështjes, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, referuar pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

## **VI. KONKLuzion PËRFUNDIMTAR**

Subjekti i rivlerësimit, z. Edison Ademi:

- Ka bërë deklaramë të pamjaftueshme për kriterin e kontrollit të pasurisë, parashikuar nga neni 61/3, i ligjit nr. 84/2016, dhe si rrjedhim, nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
- Në vlerësimin tërësor të rrethanave, ka cenuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë, parashikuar nga neni 61/5 i ligjit nr. 84/2016.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në bazë të gurmës "c", të pikës 1, të nenit 58, referuar nenit 61, pika 3 dhe 5, të ligjit

nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit z. Edison Ademi, me detyrë prokuror/drejtues pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 09.04.2019.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**KRYESUES**  
**Genta Tafa (BUNGO)**

**RELATOR**  
**Firdes SHULI**

**ANËTAR**  
**Lulzim HAMITAJ**

*Sekretare gjyqësore*  
*Anisa Duka*